



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PRISHTINËS

Drejtoria i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



PLANI RREGULLUES

“DARDANIA”

Prishtinë

ZGJIDHJA URBANISTIKE



Qershor 2009

Drejtor i Drejtoratit të UKMM
Dipl. Ing. Shiqeri Spahiu

Kryetari i Komunës së Prishtinës
Prof.Dr. Isa Mustafa



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PRISHTINËS

Drejtoria i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



PLANI RREGULLUES ***“DARDANIA”***

Prishtinë

Bartësi i Projektit



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PRISHTINËS
Drejtoria i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së
Mjedisit





Hartues i Projektit



Lin-Projekt sh.p.k.

Rr. Mbretëresha Teutë p.n., Mitrovicë, Kosovë

Tel. / Fax +381 (0)28 534 717

www.linprojekt.com

<i>Menaxher</i>	Luan Kabashi i.d.a.
<i>Projektues / Hartues</i>	Hylki Salihu i.d.a.
	Jusuf Haxhimehmeti i.d.a.
	Armand Gashi i.d.a.
	Fejzullah Haxhani i.d.a.
	Pleurat Avdiu i.a.
	Arben Zeqiri i.d.a.
	Sami Zeka i.d.a.
<i>Hartues të fazave</i>	
<i>Komunikacioni</i>	Xhavit Hasani i.k.
<i>Instalimet elektrike dhe telefonike</i>	Lulzim Bunjaku i.d.e.
<i>Instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit</i>	Hatixhe Haxha i.d.h.
<i>Instalimet e ngrohjes</i>	Sami Abdullahu i.m.
<i>Rregullimi i sipërfaqeve të gjelbëruara</i>	Ismet Babaj i.d.agr.



PËRMBAJTJA

A. PJESA TEKSTUALE

1.	HYRJE	8
2.	GJENDJA E PROJEKTUAR DHE AJO EKZISTUESE	9

B. ZGJIDHJA URBANE

1.	SYNIMET DHE VIZIONI	12
2.	KONCEPTI	13
3.	KONCEPTI URBAN – ARKITEKTONIK	14
4.	INTERVENIMET NË GJENDJEN EKZISTUESE	15
5.	NDARJA ZONALE E INTERVENIMEVE	15
6.	ZONAT SIPAS DENDËSISË SË SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRËS ...	16
7.	RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT TË PARCELAVE ..	18
8.	ETAZHITETI I OBJEKTEVE	22
9.	OBJEKTET E BANIMIT	22
10.	ZONAT SIPAS DESTINIMEVE TË ZGJIDHJES URBANE	23
11.	KARAKTERISTIKAT E ZONAVE URBANE	25
12.	TREGUESIT E PËRGJITHSHËM RREGULATIV TË NDËRTIMIT	29
	• Zona urbane 1	29
	o Blloku 1a	29
	o Blloku 1b	42
	o Blloku 1c	48
	o Blloku 1d	56
	o Blloku 1e	63



• Zona urbane 2	68
• Zona urbane 3	74
○ Blloku 3a	74
○ Blloku 3b	80
• Zona urbane 4	87
○ Blloku 4a	87
○ Blloku 4b	94
• Zona urbane 5	100
○ Blloku 5a	100
○ Blloku 5b	109
○ Blloku 5c	114
• Zona urbane 6	120
○ Blloku 6a	120
○ Blloku 6b	126
• Zona urbane 7	136
○ Blloku 7a	136
○ Blloku 7b	144
• Zona urbane 8	148
○ Blloku 8a	148
○ Blloku 8b	156
○ Blloku 8c	164
○ Blloku 8d	170
• Zona urbane 9	180
○ Blloku 9a	180
○ Blloku 9b	188
○ Blloku 9c	196
• Zona urbane BK1	204
• Zona urbane BK2	211



13. TRAFIKU DHE TRANSPORTI	217
14. RRJETI ELEKTROENERGJETIK DHE TELEKOMUNIKUES	219
15. NDRIÇIMI	220
16. RRJETI TERMOENERGJETIK	221
17. INFRASTRUKTURA HIDROTEKNIKE	222
I. RRJETI PËR FURNIZIM ME UJË TË PIJES	222
II. RRJETI I UJËRAVE FEKALE DHE ATMOSFERIKE	223
III. POZITA E LUMIT PRISHTINA	225
18. GJELBËRIMI	225
19. DISPOZITAT PËR TRAJTIMIN E MBINDËRTIMEVE.....	227
20. INTERVENIMET DHE RINOVIMET	228
21. PLANI I PARCELIMIT DHE RIPARCELIMIT	229
22. NORMAT DHE STANDARDET TEKNIKE PËR ZHVILLIM URBAN	229
23. KUSHTET DHE KRITERET PËR MBROJTJE MJEDISORE	233
24. KUSHTET DHE KRITERET PËR SHFRYTËZIM RACIONAL TË ENERGJISË	233
25. KUSHTET URBANE PËR SIPËFAQET PUBLIKE , PRIVATE SI DHE ELEMENTET PËRCJELLËSE	234
26. KUSHTET E DHE RREGULLORET E DOMOSDOSHME PËR LËSHIMIN E LEJES NDËRTIMORE , SIPAS VENDIT DHE LLOJIT TË OBJEKTIT QË ËSHTË DUKE U NDËRTUAR	234
27. VLERAT ME RËNDËSI NATYRORE, KULTURORE DHE HISTORIKE	235
28. KUSHTET PËR MBROJTJE NGA ZJARRI DHE FATKEQËSITË TJERA SI DHE SHKATËRRIMET	235
29. REZYME E REKOMANDIMEVE TË PËRGJITHSHME	235



C. PJESA HARTOGRAFIKE

1. EKSTRAKT NGA PLANI STRATEGJIK -ZHVILLIMI URBAN I PRISHTINËS 2004 – 2020
2. KUFIRI E PLANIT RREGULLUES
3. EKSTRAKT NGA PLANI DETAL URBANISTIK 1973
4. GJENDJA EKZISTUESE (INÇIZIMI GJEODEZIK)
5. DESTINIMI I SIPËRFAQEVE
6. ZGJIDHJA URBANISTIKE
7. ZGJIDHJA URBANISTIKE
8. PLANI I RRËNIMIT
9. PLANI I PARCELIMIT
10. ZONIMI
11. PLANI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE
12. PRERJA TËRTHORE E RRUGËVE
13. PLANI NIVELUES
14. PLANI I GJELBËRIMIT
15. RRJETI I TELEKOMUNIKACIONIT
16. RRJETI ELEKTROENERGJETIK
17. SISTEMI I NGROHJËS
18. SISTEMI I UJËSJELLËSIT
19. SISTEMI I KANALIZIMIT
20. PRONËSIA
21. 3D



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PRISHTINËS

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



Pjesa tekstuale



1. HYRJJE

Hapësira urbane “Dardania” ka një formë trekëndëshi e përkufizuar me rrugë mjaft të qarkulluara. Kjo hapësirë urbane shtrihet në jug-perëndim të bërthamës së qytetit dhe me të lidhet përmes “Bulevardit Bill Klinton” dhe “Bulevardit të Dëshmorëve”.

Në anën lindore të hapësirës urbane “Dardania” gjendet Lagja Ulpiana, ndërsa “Bulevardi Bill Klinton” e ndan këtë hapësirë urbane nga lagja “Lakrishte” dhe lagja “Pejton”. Nga ana jugore të kësaj zone lagja “Dardania” përkufizohet përmes rrugës, unaza qendrore me lagjen “Kalabria”.

Hapësira urbane “Dardania” mbulon një sipërfaqe bruto: 57.35 ha (aksi i rrugëve perimetrike të lagjes).

Konfiguracioni i Hapësirës urbane “Dardania” është kryesisht i rrafshët. Vlerë dhe theks të veçantë të kësaj hapësire urbane paraqesin sipërfaqet e konsiderueshme të lira dhe të gjelbëruara.

Në hapësirën urbane “Dardania” ndërtimi i objekteve daton prej vitit 1946, kryesisht ndërtime këto me material të fortë ndërtimor. Periudha e pas luftës (1999) këtë lagje e karakterizon me uzurpime, ndërtime dhe mbindërtime pa leje si dhe degradim të objekteve dhe hapësirave të përbashkëta.

Në periudhën e kaluar kohore, për këtë lagje, janë hartuar disa projekte, me qëllim të ngritjes së nivelit të banimit, punës, rekreacionit, pra të jetës në përgjithësi. Në funksion të kësaj me hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit Urban të Prishtinës (2004 – 2020), imperativ i kohës është hartimi i Planit Rregullues të lagjes “Dardania”.

Falë hartimit dhe realizimit nëpër kohë të planeve, lagja “Dardania” do të ofrojë hapësirë dhe rrethinë urbane të organizuar me infrastrukturë dhe shërbime publike që si të tilla paraqesin një lehtësi për vetë banorët e saj dhe qytetin në përgjithësi, duke krijuar kështu një letërnjoftim si pjesë urbane e qyteteve të mëdha botërore.



2. GJENDJA E PROJEKTUAR DHE GJENDJA EKZISTUESE E LAGJES “DARDANIA”



Ekstrakt nga Plani Detal Urbanistik i lagjes Dardania (1973)



Gjendja ekzistuese e lagjes Dardania (2007)



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PRISHTINËS

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



ZGJIDHJA URBANE



1. SYNIMET DHE VIZIONI

Bazë për hartimin e Planit Rregullues “Dardania” është plani Strategjik Zhvillimor i Prishtinës (2004-2020). Sipas këtij plani kjo zonë është trajtuar si zonë me përmbajtje mikse urbane: afarizëm, banim kolektiv, arsim, kulture, shëndetësi, rekreacion dhe hapësira të gjelbërta.

Me Planin Rregullues synohet të arrihet:

- Sigurimi dhe destinimi i sipërfaqeve për përmbushjen e nevojave të banorëve të kësaj zone hapsirore
- Mundësia e ndërtimit me koncesion – banim kolektiv dhe afarizëm me interes të pronarëve dhe investitorëve në funksion të zonës urbane
- Shfrytëzim racional dhe ekonomik i tokës ndërtimore
- Sigurimi i infrastrukturës së re teknike komunale: ujësjellësi, kanalizimi, instalimet elektrike, ngrohja qendrore, gazifikimi, rrjeti i internetit, sistemi i rrjetit kablovik, telefonia, etj.
- Integrimi i objekteve të reja të banimit atyre publike, sociale etj. në kuadër të hapsirës urbane
- Ngritja e nivelit të kushteve dhe mundësive për banim, punë, argëtim, rekreacion, gjelbërim etj.
- Eliminimi i pikave ndotëse dhe krijimi i mundësive për jetë të shëndoshë në ambiente të pastërta dhe të shëndosha
- Meliorimi dhe mbrojtja e gjelbërimit ekzistues dhe shfrytëzimi i hapësirave gjelbëruese për rekreim, argëtim dhe pushim
- Mundësia e shkarkimit të komunikacionit në hapësirën urbane me synim që zonat urbane të jenë të integruara, funksionale dhe shkallë të ngritjes së sigurisë.
- Për persona me aftësi të kufizuara, pleq, fëmijë dhe ata që jetojnë me ndihma sociale, qasje gjithëpërfshirëse në të gjithë sektorët e komunitetit

Vizioni i Planit Rregullues “Dardania”:

- Të jetë i implementueshëm
- Të ketë vazhdimësi urbane me forma gjeometrike
- Të krijojë një ambient aktiv
- Respektimi në kontekst me lagjet që e tangjentojnë
- Të ketë përmbajtje reprezentative
- Të ketë koncept bashkëkohor
- Lagje për jetë të qetë dhe mjedis të shëndoshë
- Vlerë të arsyeshme në investime



2. KONCEPTI

Koncepti themelor bazohet në aspektin funksional, organizativ dhe të formësimit të bazuar në kërkesat e projektimit urbanistik-arkitektonik.

Plani Rregullues do të vendosë kushtet për ndërtim racional dhe ekonomik me qëllim që zgjidhja në përgjithësi të paraqesë tendencë të arritjeve bashkëkohore urbanistike gjegjësisht të të kuptuarit të ri të hapësirave urbane (rregullimi i rrethinës, të problemit të orientimit, të vlerave informative) si dhe të të ashtuquajturave të më shumë funksioneve urbane.

Kërkesat programore i hartuan Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim pranë Kuvendit Komunal në Prishtinë.

Me tezat programore, janë definuar kushtet e caktuara urbanistike, të bazuara në Planin Strategjik të Zhvillimit Urban të Prishtinës (2004 – 2020) dhe në bazë të hartimit të projekteve dhe ndërtimit kronologjik të kësaj lagjeje.

Koncepti themelor mundë do të zbërthehet me anë të këtyre pikave:


- Hapësira Urbane “Dardania” është trajtuar si një ndër hapësirat më të organizuara në kuadër të organizimit urbanistik të qytetit.
- Ekuilibrimi në mes të ekzistueses dhe asaj të projektuar.
- Shpërndarja, ndryshimi dhe plotësimi i përmbajtjeve funksionale (banimi, furnizimi, arsimit, shëndetësia, kultura, rekreacioni, etj.) ishte synim që të kënaqin aspektin funksional dhe organizativ.
- Format ekzistuese gjeometrike janë udhërrëfim dhe pikësynim për t’i përballuar “dhëmbit” të kohës.
- Zgjidhja urbanistike është e bazuar në konceptin e njësisë themelore hapësinore – njësisë së banimit.
- Me kombinimin e përmbajtjeve me funksione të ndryshme urbane është eliminuar karakteri monofunksional.
- Sipërfaqet e parterit të kuptohen si kombinim i hapësirave të brendshme dhe të jashtme.
- Ndryshimi dhe plotësimi i rrjetit të komunikacionit duke iu përshtat konceptit të banimit, ka për qëllim shkarkimin dhe krijimin e mundësisë së qarkullimit të lirshëm të këmbësorëve.
- Mundësia që me gjelbërim, zgjidhje të materialeve, ngjyra dhe me përmbajtje të iu mundësohet pjesëve të caktuara në kuadër të hapësirës urbane të reflektojnë specifikat dhe karakteristikat e tyre në mënyrë që ato të identifikohen dhe të mundësojnë orientim të lehtë në kuadër të hapësirës urbane.
- Problemet sociale janë të vogla dhe krahasuar me at që arrihet në fund, ato mund të konsiderohen si ndërhyrje të vogla në proces.



3. KONCEPTI URBAN - ARKITEKTONIK

Organizimin e brendshëm strukturor të hapësirës urbane “Dardania” e përbëjnë kushtëzimet e ndërsjella dhe shpërndarja e projektuar e zonave të caktuara dhe funksioneve. Struktura organizative është e shprehur me pozitën e qendrës dhe lidhjes funksionale si dhe shpërndarjes së objekteve të banimit, objekteve publike, të arsimit, kulturës, shëndetësisë, objekteve të infrastrukturës si dhe rrjetit të qarkullimit.

Hapsira urbane “Daradania” në Planin Rregullues është koncipuar në 11 zona urbane. Me rrënimin e disa objekteve individuale, parcelat mundsishhtë të bashkohen dhe me formën e koncesionit duhet të bashkohen sa më shumë për të krijuar kushtet e zhvillimit urbanistiko-arkitektonik të zonës.





4. INTERVENIMET NË GJENDJEN EKZISTUESE

Në bazë të analizave u caktuan parimet që do të vlejné:

- për objektet të cilat kanë vlerë dhe të cilët do të ruhen
- për objektet të cilat nuk kanë ndonjë vlerë, paraqesin pengesë dhe nuk do të trajtohen gjatë planifikimit pra do të rrënohen dhe
- sipërfaqet e destinuar për objektet e reja.

5. NDARJA ZONALE E INTERVENIMEVE





6. ZONAT SIPAS DENDËSISË SË SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRËS

Për tu trajtuar sa më mirë është bërë ndarja e hapsirës urbane në zona. Kjo ndarje mundëson që sa më saktë të llogariten indeksat e shpëtës së parcelës (ISHP) dhe indeksat e shfrytëzimit të dyshemesë (ISD).

Blloku	Sipërfaqja e bllokut (m ²)	Shputa (m ²)	Sipërfaqja totale ndërtimor e (m ²)	Indeksi i shfrytëzueshmërisë së parcelës ISHP	Indeksi i shfrytëzueshmërisë së parcelës ISHD	Banorë
1a	56165	18641	106147	0,3	1,9	2483
1b	11489	1944	13377	0,2	1,2	511
1c	14161	3785	24562	0,3	1,7	0
1d	20554	5831	41609	0,3	2,0	0
1e	5541	0	0	0,0	0,0	0
2	20178	3133	21081	0,2	1,0	869
3a	21970	9578	21970	0,4	1,0	0
3b	10469	5352	16251	0,5	1,6	898
4a	18475	5333	35131	0,3	1,9	1646
4b	12953	2738	10659	0,2	0,8	312
5a	26167	11088	73090	0,4	2,8	2201
5b	15421	3884	9236	0,3	0,6	0
5c	7716	1684	10106	0,2	1,3	288
6a	22423	1913	12594	0,1	0,6	554
6b	19136	6851	30972	0,4	1,6	1097
7a	27838	6232	29725	0,2	1,1	1155
7b	7608	0	0	0,0	0,0	0
8a	11382	3199	23439	0,3	2,1	160
8b	10304	2291	32075	0,2	3,1	898
8c	14873	1754	24553	0,1	1,7	491
8d	22045	5589	68107	0,3	3,1	1328
9a	11695	2903	7423	0,2	0,6	278
9b	14515	1780	25069	0,1	1,7	899
9c	9245	1341	29289	0,1	3,2	790
BK1	18518	9118	39315	0,5	2,1	1368
BK2	16009	3916	37130	0,2	2,3	1301
Totali	446850	119878	742910	0,3	1,7	19527



Në tabelën e mëposhtme janë prezantuar sipërfaqet e përgjithshme të ndërtimit sipas blloqeve urbanistike (gjendja ekzistuese dhe e planifikuar):

Blloku urbanistik	Gjendja ekzistuese	Objektet që ruhen	Rrënim	Planifikim	Totali sipas Zgjidhjes Urbane
	(m ²)	(m ²)	(m ²)	(m ²)	(m ²)
1a	108554	104583	3971	1564	106147
1b	13609	13377	232	0	13377
1c	6018	5636	382	18926	24562
1d	8287	2429	5858	39180	41609
1e	305	0	305	0	0
2	21698	21081	617	0	21081
3a	6901	6000	901	15970	21970
3b	16251	16251	0	0	16251
4a	41024	35131	5893	0	35131
4b	10659	10659	0	0	10659
5a	77461	73090	4371	0	73090
5b	3907	3907	0	5329	9236
5c	10106	10106	0	0	10106
6a	13689	12594	1095	0	12594
6b	32130	30972	1158	0	30972
7a	30818	29725	1093	0	29725
7b	0	0	0	0	0
8a	19031	15914	3117	7997	23911
8b	9044	0	9044	32075	32075
8c	8582	0	8582	24553	24553
8d	11512	1688	9824	66419	68107
9a	9221	6497	2724	926	7423
9b	31264	25069	6195	0	25069
9c	32274	29289	2985	0	29289
BK1	40537	39315	1222	0	39315
BK2	37112	32496	4616	10002	42498
Totali	599994	525809	74185	222941	748750

Rekapitulim i të dhënave mbi shfrytëzimin e hapësirës:

Numri i i banorëve			19 527
Numri i banorëve për hektar			374
Sip. bruto e lagjes (aksi rrugor i bulevardit/unazës)	573 542 m²		57.35 ha
Sip. e lagjes	522 749 m²		52.27 ha
Sip. e trolit të ndërtuar	119 878 m²	11.99 ha	22,9 %
Sip. nën Rrugë	71 232 m²	7.12 ha	13.6 %
Sip. e lira	331 639 m²	33,16 ha	63,4 %



Dendësia urbane dhe etazhiteti sipas Planin Strategjik të Zhvillimit Urban të Prishtinës (2004 - 2020):

Etazhiteti	Indeksi i banimit (ISHP)	Indeksi i hapsirës (ISD)
IV	0,6 – 0,8	Max. 3,0

7. RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT TË PARCELAVE

Sipas parimeve të përgjithshme treguesit themelor urbanistik në të cilët bazohet rregullimi i parcelave janë:

- ISHP – Indeksi i shfrytëzimit të parcelës
- ISD – Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë
- Vija rregulluese
- Vija ndërtimore

ISHP – Indeksi i shfrytëzimit të parcelës paraqet sipërfaqen e lëjuar për ndërtim (shputa e objektit) në kuadër të sipërfaqes së parcelës që përfshihet brenda vijës rregulluese.

ISD – Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë paraqet koeficientin me të cilin shumëzohet sipërfaqja e parcelës brenda vijës rregulluese për të fituar sipërfaqen totale të lejuar për ndërtim.

Shfrytëzimi i nëntokës paraqet përqindjen e lejuar të shfrytëzimit të sipërfaqes së parcelës e cila përfshihet brenda vijës rregulluese duke respektuar vijën ndërtimore në nivelin e përdhësës.

Shfrytëzimi i mbitokës paraqet përqindjen e lejuar të shfrytëzimit të sipërfaqes së parcelës e cila përfshihet brenda vijës rregulluese duke respektuar vijën ndërtimore.

VIJA NDËRTIMORE DHE RREGULATIVE

Vija ndërtimore dhe rregulative përcaktohet me Planin Rregullues Dardania dhe është bazë për Projektin Urbanistik dhe Lejen Urbanistike. Me këtë plan, vija ndërtimore gjithmonë është përcaktuar në raport me vijën rregulluese (e prezantuar në shtojcën grafike për çdo bllok veçanarisht).

Vija rregulluese siguron korridorin për vendosjen e rrjetës (primare dhe sekondare) të infrastrukturës (ujësjellësit, kanalizimit, PTT, rrjetit të gazit, ngrohjes, etj.).



DISTANCA NË MES TË OBJEKTEVE

Per caktimin e distancave ndermjet objekteve meren tre faktore:

1. Orientimi
2. Gjendja e fqinjësisë
3. Kërkesat higjiene sanitare

Orientimi - Tek orientimi merret kusht bazik orientimi drejt jugut deri në 40 gradë të tij si dhe tri orë diell në periudhën 22 mars – 22 shtator

Gjendja e fqinjësisë - Tek gjendja e fqinjësisë mbahet parasysh krijimi i hapësirave të nevojshme funksionale ndërmjet ndërtimeve.

Kërkesat higjiene sanitare - Tek kërkesat higjiene sanitare përfshihen kërkesat për ndriçim, diellzim dhe ajrim të nevojshëm të objekteve.

Distanca minimale e objekteve apo ndërtesave nga bordura (skejoret) e rruges për rrugë qyteti duhet të jete :

- Jo me pak se 5m per rruge me gjeresi deri në 7 m
- Jo me pak se 7.5m per rruge me gjeresi prej 7 - 15 m
- Jo me pak se 10m per rruge me gjeresi mbi - 15 m

Parametrat e distancave ndermjet objekteve :

a) Kur ndërtesat vendosen karshi njëra tjetrës dhe kanë gjatësi deri 20 m'

Për ndërtesa	1 kat	2 kat	3 kat	4 kat	5 kat	6 kat	7 kat	8 kat	9 kat	10 kat	11 kat	12 kat
Distanca duhet të jetë jo më pak se	4 m'	6 m'	8 m'	10 m'	12 m'	14 m'	16 m'	18 m'	20 m'	22 m'	24 m'	26 m'

Për ndërtesa mbi 12 kate distancat përcaktohen sipas studimeve urbanistike dhe projekteve të tyre konkrete.

b) Kur ndërtesat vendosen karshi njëra tjetrës dhe kanë gjatësi mbi 20 m'

Për ndërtesa	1 kat	2 kat	3 kat	4 kat	5 kat	6 kat	7 kat	8 kat	9 kat	10 kat	11 kat
Distance duhet të jetë jo më pak	6 m'	9 m'	13.5 m'	18 m'	20 m'	22 m'	24 m'	26 m'	27 m'	28 m'	29 m'



Për ndërtesa mbi 12 kate distancat përcaktohen sipas studimeve urbanistike dhe projekteve të tyre konkrete.

c) Kur ndërtesat vendosen karshi njëra tjetrës dhe kanë variabilitet katesh

Distanca ndërmjet dy ndërtesave me numër të ndryshëm katesh përcaktohet me metodën e interpolimit dmth. të dy ndërtesat konsiderohen me numër të njëjtë katesh që është e barabartë me mesataren e shumës së numrit të kateve të tyre.

Shembull: $4 \text{ kat} + 8 \text{ kat} = 12 \text{ kat}$ $12 / 2 = 6 \text{ kat}$

d) Kur ndërtesat vendosen përbri njëra tjetrës

Kur ndërtesat vendosen përbri njëra – tjetrës dhe faqet në brinjë nuk kanë dritare mund të largohen deri në 1 m apo në bashkim të plotë duke respektuar diletimin me kusht që të merren masa të caktuara për mbrojtje nga zjarri duke lënë nënkallime me gjerësi 4m dhe lartësi 5m .

e) Kur ndërtesat vendosen afër ndërtesave me karakter arsimor dhe shëndetësor

Distancat e objekteve të banimit nga cerdhet , shkollat , kopshtet , ambullantat duhet të jenë jo më pak se 1,5 herë e lartësisë së objektit me te lartë që qëndron nga jugu kurse për orientimet tjera vlejne distancat e përcaktuara në **a,b,c**.

Konsolat

Dalja konsolë e mbi 50 % të faqes së ndërtesës kualifikohet si faqe ndërtimi dhe mirret parasysh në përcaktimin e distancave ndërmjet ndërtesave dhe nuk duhet të kalojë jashtë vijës së ndërtimit.

Lartësia e objektit

Lartësia e objektit është niveli nga kuota ± 0.00 e objektit deri në kulm (për objektet me kulm të pjerrët), respektivisht deri te kurora e kulmit (për objektet me kulm të rrafshët).



Niveli i përdhesës në raport me nivelin e rrugës publike

Niveli ± 0.00 e përdhesës së objektit përcaktohet në raport me nivelin e rrugës publike:

1. Niveli i përdhesës së objektit nuk mund të jetë më i ulët se niveli i rrugës publike
2. Niveli i përdhesës mund të jetë më së larti 1.20m nga niveli i rrugës
3. Objektet në terren të pjerrët, me ramje nga rruga (poshtë), kur niveli ± 0.00 është më i ulët se niveli i rrugës publike, atëherë niveli i përdhesës mund të jetë më së shumti -1.20m nga niveli i rrugës publike
4. Objektet të cilat në përdhesë kanë destinim afarist, niveli mund të jetë më i lartë se niveli i trotuarit për më së tepërmi 0.15m

Daljet nga gabariti i objektit

Pjesët e objektit (daljet) mbi nivelin e përdhesës mund të kalojnë vijën ndërtimore respektivisht vijën rregullative deri 1.20 m.

Reklamat si konzolla lejohen dalje nga gabariti themelor i objektit max 1.20m dhe në lartësi jo më të ulët se 3.0 m (pjesa e poshtme e reklamës).

Elementet ndërtimore nën kuotën e trotuarit dhe etazhet e bodrumeve, mund të kalojnë vijën ndërtimore duke llogaritur nga gabariti themelor i objektit deri te projeksioni horizontal i daljes dhe atë:

- shputat e themelit nuk mund të kalojnë kufirin e parcelës fqinje
- pusetat ndriçuese të hapësirave të bodrumit deri në nivelin e kotës së trotuarit mund të kalojnë vijën ndërtimore respektivisht rregulluese më së tepërmi 1.00 m.

Rrethojat

Parcelat ndërtimore të objekteve kolektive banesore, afariste dhe objekteve tjera publike, përveq shkollave, institucioneve parashkollore, QMF etj.) nuk rrethohen.

Rrethojat në parcelat ndërtimore në të cilat ndodhet objektet sociale (shkolla, institucionet për fëmijë, QMF etj.) të rrethohen me rrethojë-mur në lartësi deri 0.80m (duke llogaritur prej nivelit të trotuarit) apo rrethojën transparente deri në lartësi 1.40 m, por edhe forma të kombinuara të formësimit dhe dizajnit urb-arkitektonik duke respektuar lartësitë e cekura..

Rrethojat e objekteve në kënde nuk mund të jenë më të larta se 0.80m duke u llogaritur nga kuota e trotuarit, për shkak të përceptimit vizuel.



Raporti i banimit dhe veprimtarive ekonomike në objektet kolektive të banimit

Raporti i banimit dhe veprimtarisë ekonomike në objektet e banimit kolektiv është i përcaktuar me këtë plan për çdo bllok në veçanti.

Në rrugët të cilat janë të caktuara si bartëse të rëndësishme të zhvillimit të veprimtarive qendrore në funksion të qytetit, banimi në këto objekte nuk është i lejuar në përdhese dhe katin e parë (bulevardet).

Parcela ndërtimore dhe rregullat e përgjithshme të parcelimit

Njësia më e vogël ku mund të ndërtohet është parcela ndërtimore. Ajo definohet me vijën rregulluese ndaj rrugës publike, kufijve të parcelave ndaj parcelave të fqinjëve dhe të gjitha pikave thyese të nevojshme për shënim në teren, të cilat caktohen sipas koordinatave absolute shtetërore në sistemin Gauss Krüger.

Parcela ndërtimore është njësia më e vogël ku mund të ndërtohet. Parcela minimale për ndërtim duhet të ketë minimumi 600 m². Për arritjen e sipërfaqes minimale të parcelës ndërtimore duhet të bëhet grupimi me parcela fqinje dhe si të tilla duhet të regjistrohen në librat kadastral.

Parcelat me formë të çrregullt gjeometrike dhe që nuk e kanë front (daljen në rrugë) më të gjerë se 20 m duhet të bashkohen me parcelat fqinje për të krijuar kushtet minimale për ndërtim.

8. ETAZHITETI I OBJEKTEVE

Etazhiteti i objekteve është përcaktuar sipas zonës në të cilën ndodhen, duke respektuar parametrat ndërtimorë të indeksit të shfrytëzimit të dyshemesë (ISD) dhe indeksit të shpëtës së parcelës (ISHP). Për Zonën 8 etazhiteti është i lejuar deri në P+10.

Te gjitha ndërtesat e reja mund të përmbajnë etazhin e bodrumit përpos në rastet kur është e pamundur për shkak të nivelit të lartë të ujërave nëntokësore apo të ndonjë arsyeje tjetër teknike.

9. OBJEKTET E BANIMIT

Është respektuar ndërtimi ekzistues i cili do të ruhet, kryesisht objektet e banimit kolektiv, objektet administrative, të institucioneve parashkollore dhe të arsimit, shëndetësisë, serviseve, etj.

Objektet e banimit janë të shtrira dhe të organizuara në zona urbane (Billoqe).



Objektet individuale të banimit (Zona 8; 9a dhe Zona Bk2), do të rrenohen po qe se gjendet modusi për ndërmarrjen e këti hapi. Përmbajtjet e zonave urbane, do të plotësohen dhe do të ndryshohen sipas destinimit të prezantuar në këtë projekt.

Koncepti i objekteve të banimit është i definuar parimisht me rrugën banimore, pra me drejtimin e lëvizjes së këmbësorëve me të cilat nga të gjitha anët e lagjes arrihet tek përmbajtjet e qendrës dhe nënqendrës së lagjes.

10. ZONAT SIPAS DESTINIMEVE TË ZGJIDHJES URBANE

Destinimi i Zonave urbane të hapësirës urbane “Dardania” me koncept themelor në aspektin funksional, organizativ dhe të formësimit është i bazuar në Planin Strategjik të Zhvillimit Urban të Prishtinës (2004-2020) dhe në bazë të hartimit të projekteve dhe ndërtimit kronologjik të kësaj lagjeje duke u plotësuar dhe ndryshuar sipas destinimit të prezantuar me këtë projekt.

- **Zona urbane 1**

Karakterizohet si zonë mikse urbane me përmbajtje të funksioneve të banimi, afarizmit, biznes, administratë. Objektet kryesisht janë të ndërtuara sipas zgjidhjes urbanistike të Planit Detal Urbanistik të vitit 1972. Përveç këtyre ekzistojnë edhe objekte të cilat do të mbesin siç janë, objektet e banimit kolektiv dhe individual, objektet e ndërmarrjeve publike (Ngrohtorja e Qytetit, “Termokos” dhe PTK), qendra tregtare, çerdhja e fëmijëve “Lulevera”. Në kuadër të kësaj tërësie urbane janë përfshirë edhe zona të gjelbëruara dhe ndërtimi i dy garazheve nëntokësore. Në kë zonë është planifikuar edhe blloku i veçantë me përmbajtje administrative (Blloku1d).

- **Zona urbane 2**

Destinimi i zonës është kryesisht me banim (banim kolektiv). Objektet, që ruhen janë ato të ndërtuara sipas zgjidhjes urbanistike të Planit Detal Urbanistik nga viti 1972. Në këtë zonë planifikohet ndërtimi i një garazhe nëntokësore me përmbajtje në sipërfaqe të sajë me gjelbërim, sipërfaqe për lojë të fëmijëve dhe pushim.

- **Zona urbane 3**

Karakterizohet si zonë mikse urbane me përmbajtje të funksioneve të banimi, arsimit (parashkollor dhe shkollor), afarizmit, biznes, administratë. Objektet janë të ndërtuara sipas zgjidhjes urbanistike të Planit Detal Urbanistik të vitit 1972. Të gjitha objekte sipas këtij plani do të mbesin siç janë objektet e banimit kolektiv dhe individual, qendra e Bashkësisë Lokale Dardania si dhe Shkolla Fillore “Dardania”. Në kuadër të kësaj tërësie urbane është përfshirë edhe zona të gjelbëruara dhe ndërtimi i çerdhes së



fëmijëve dhe zgjerimi (ndërtimi) i shkollës fillore pranë shkollës ekzistuese “Dardania” me të gjitha përmbajtjet përcjellëse.

- **Zona urbane 4**

Zonë urbane me përmbajtje të funksioneve të banimi, afarizmit, rekreacioni dhe gjelbërimi. Objektet kryesisht janë të ndërtuara sipas zgjidhjes urbanistike të Planit Detal Urbanistik të vitit 1972. Përveç këtyre ekzistojnë edhe objekte të cilat do të mbesin siç janë objektet e banimit kolektiv. Në kuadër të zonës është përfshirë edhe zona të gjelbëruara, fusha për sport dhe rekreacion dhe ndërtimi i një garazhe nëntokësore.

- **Zona urbane 5**

Karakterizohet si zonë mikse urbane me përmbajtje të funksioneve të banimi, afarizmit, biznes, administratë, arsim, etj. Objektet kryesisht janë të ndërtuara sipas zgjidhjes urbanistike të Planit Detal Urbanistik të vitit 1972. Përveç këtyre ekzistojnë edhe objekte të cilat do të mbesin siç janë objektet e banimit kolektiv. Në kuadër të kësaj tërësie urbane është përfshirë edhe zona të gjelbëruara dhe përmbajtjet afariste-trgëtare si dhe ndërtimi i bibliotekës së qytetit.

- **Zona urbane 6**

Zonë urbane me përmbajtje kryesisht të banimit, afarizmit, rekreacioni dhe gjelbërimi. Objektet janë të ndërtuara sipas zgjidhjes urbanistike të Planit Detal Urbanistik të vitit 1972. Në kuadër të zonës është përfshirë edhe zona e gjelbëruar, fusha për sport dhe rekreacion dhe ndërtimi i garazhës nëntokësore.

- **Zona urbane 7**

Destinimi i zonës është kryesisht me banim kolektiv. Objektet, që ruhen janë ato të ndërtuara sipas zgjidhjes urbanistike të Planit Detal Urbanistik nga viti 1972. Në këtë zonë planifikohet rregullimi i shtratit të lumit Prishtevka, krijimi i shtigjeve për këmbësorë, oazave gjelbëruese, hapësirave relaksuese, për argëtim dhe këndeve për lojërë fëmijësh. Gjelbërim i lartë amortizues i zhurmës dhe pluhurit, shtigje për këmbësorë, shtigje për vrapim, shtigje për biçiklista, stola për pushim, shatërvane dhe elemente tjera mikrourbane.

- **Zona urbane 8**

Karakterizohet si zonë mikse urbane me përmbajtje të funksioneve të banimit kolektiv (objektet ekzistues dhe ndërtim i ri me koncesion), qendra e lagjes Dardania, biznes, administratë, tregti. Përveç këtyre ekzistojnë edhe objekte të cilat do të mbesin siç është objekti shëndetësor (Ambulanca e lagjes) dhe objektet administrative dhe ekonomike të KEK-ut. Në kuadër të kësaj tërësie urbane është përfshirë edhe zona të gjelbëruara dhe ndërtimi i Qendrës së lagjes (në pjesën jugore, blloku 8d) me përmbajtjet përcjellëse kulturore-publike-afariste (sheshin, kinema, teatër, galeri, qendra mediale, restorante, etj.). Hapësirat e parkingjeve, garazheve nëntokësore, rrugëve



interne, shtigjeve për këmbësorë, hapësirat e lojërave për fëmijë, sipërfaqe të gjelbëruara, etj. Për Zonën 8 të hartohet projekt i veçantë për zgjidhja urb-arkitektonike e Zonës 8, implementimi i të cilit sipas dispozitave të këtij plani do të bëhet nëpër blloqe.

- **Zona urbane 9**

Zonë urbane me përmbajtje kryesisht të banimi kolektiv dhe përmbajtje afariste (biznes, administratë dhe tregti) si dhe me përmbajtje tjera përcjellëse (parking, sheshe, çerdhe e fëmijëve dhe hapësira për lojëra të fëmijëve, sipërfaqe të gjelbëruara). Objektet janë të ndërtuara sipas zgjidhjes urbanistike të Planit Detal Urbanistik të vitit 1972. Në kuadër të zonës janë përfshirë edhe zona të gjelbëruara dhe hapësirat e lojërave për fëmijë dhe pushim.

- **Zona urbane BK1**

Karakterizohet si zonë mikse urbane me përmbajtje të funksioneve të banim kolektiv, biznes, administratë, tregti. Objektet janë të ndërtuara sipas zgjidhjes urbanistike të Planit Detal Urbanistik të vitit 1972 dhe si koncept i tillë objektet do të mbesin duke intervenuar në revitalizimin e fasadave të objekteve ekzistuese banesore dhe afariste dhe në përmirësimin kualitativ të kushteve për banim, punë dhe mobilitet. Në kuadër të kësaj tërësie urbane janë përfshirë edhe zona të gjelbëruara, hapësirat e parkingjeve, garazheve nëntokësore, rrugëve interne, shtigjeve për këmbësorë, hapësirat e lojërave për fëmijë, sipërfaqe të gjelbëruara, etj

- **Zona urbane BK2**

Zona karakterizohet mikse urbane me përmbajtje të funksioneve të banim kolektiv, biznes, administratë, tregti. Objektet janë të ndërtuara sipas zgjidhjes urbanistike të Planit Detal Urbanistik të vitit 1972 do të mbesin. Përpos objektit të banimit kolektiv me përmbajtje afariste është planifikuar edhe garazhi nëntokësor në disa nivele. Në kuadër të zonës janë përfshirë edhe zona të gjelbëruara dhe hapësirat e lojërave për fëmijë dhe pushimi, hapësira për vendparkime, shtigjeve për këmbësorë, hapësirat e lojërave për fëmijë dhe hapësira të rezervuara komunale për infrastrukturë.

11. KARAKTERISTIKAT E ZONAVE URBANE

Karakteristikat ekologjike

Karakteri i zonave urbane sipas standardeve duhet të i plotësojë kushtet jetësore, kushtet për punë dhe aktivitete tjera. Me Planin Rregullues përcaktohen situatat e përgjithshme progresive ekologjike me masat që vijojnë:



- Vendosja e rendit urban përmes rregullave të shfrytëzimit të tokës, rregullave të ndërtimit dhe rregullave të grupimit të parcelave
- Vendosja e rendit kadastral për parcelat e mbetura në kuadër të zonës të cilat duhet të jenë të qarta dhe precize.
- Krijimi i parakushtit bazë për përcaktimin e të drejtave të çdo individi në vizura, diell dhe ajër
- Përcaktimi i masave të shfrytëzimit të infrastrukturës dhe pajisjeve përcjellëse
- Krijimi i kushteve optimale për përcaktimin e sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit dhe për kalimin e automjeteve për intervenime të shpejta
- Krijimi i kushteve për largimin e mbeturinave dhe për qasjen e automjeteve për transportin e tyre

Zonat e ndërtimit – janë blloqet e pavarura për ndërtim në këtë tërësi urbane dhe janë të prezantuara në formë tabelare. Shënimet e sakta për madhësinë përfshirëse, kushtet e shfrytëzimit, kriteret dhe etazhiteti janë dhënë në mënyrë tabelare për çdo bllok.

Vijat ndërtimore dhe rregulluese - janë të prezantuara me shtojcat grafike. Vijat rregulluese dhe ndërtimore si dhe largësitë në mes tyre janë dhënë në formën digjitale.





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PRISHTINËS

Drejtoria i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



ZONA 1

Blloku 1a



LEGJENDA:

Objekte ekzistuese që ruhen Existing conserved objects	Çerdhe (e propozuar) Kindergarden (proposed)
Objekte ekzistuese që rrënohen Destruction of existing objects	Nën/mbi kalim Passage
Zonë ku lejohet ndërtimi Allowed zone to built	Lumi Prishtevka Prishtevka river
Parter / Gjelbërim Path & paving / Green area	Kolektori i lumit Prishtevka Prishtevka river collector
Shesh Plaza	Kufiri i planit rregullues Regulatory plan boundary
Garazhë nëntokësore - gjelbërim dhe lojra Underground garage - green area	Vija rregullative Regulatory line
Gjelbërim Green area	Vija ndërtimore Construction line
Administratë Administration	Kufiri i bllokut Block boundary
Ngrohtorja Central heating	Parcela Parcel
Zgjerim i shkollës School extension	
Zgjerim i shkollës (salla e sporteve) School extension (sports hall)	

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E PRISHTINËS/OPSTINA PRISTINA/MUNICIPALITY OF PRISHTINA

DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
 THE DEPARTMENT OF URBANISM, CADASTRE AND ENVIRONMENT PROTECTION
 DIREKCIJA ZA URBANIZAM, KATASTAR I OCUVANJE OKOLINE



ZGJIDHJA URBANE


PLANI RREGULLUES "DARDANIA"
 Regulatory plan "DARDANIA"
 Regulacioni plan "DARDANIA"

PËRMBAJTJA
SHTOJCA GRAFIKE PËR BLOKUN 1a

PROJEKTUES

VËRTETON
 DREJTORI I DREJTORATIT TË URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
 dipl.ing. SHIQERI SPAHIU
 KRYETARI I KUVENDIT KOMUNAL TË PRISHTINËS
 prof.dr. ISA MUSTAFA

Maj 2009





12. TREGUESIT E PËRGJITHSHËM RREGULATIV TË NDËRTIMIT

Zona 1

Blloku 1a

Hapësira për banim, tregti, administratë, biznes dhe arsim parashkollor

Kushtet e përgjithshme

Destinimi: Objektet ekzistuese: PTK, Qendra Tregtare, Çerdhja e fëmijëve Afarizëm, tregti, administratë, banim kolektiv-individual, garazhim dhe funksione përcjellëse (parking, sheshe, hapësira për lojëra të fëmijëve, sipërfaqe të gjelbëruara)

Lejohet: Planifikohet edhe ndërtimi i garazheve nëntokësore. Niveli i garazhës duhet të jetë i tillë që mbi të ketë një shtresë dheu minimumi 1m kështu që hapësira mbi garazh të shfrytëzohet për gjelbërim dhe hapësira për lojë e pushim. Në Bllokun 1a lejohet ndërtimi vetëm i një njësie (lamele) me gabarit dhe etazhitet të njëjtë sikurse objektet fqinjë (S+P+2) (objektet në rend) duke respektuar lartësinë (etazhitetin) e lejuar për ndërtim brenda vijës ndërtimore) me hapësirat përcjellëse për banorë, si dhe shfrytëzimi i një pjese të hapësirës për gjelbërim dhe rekreacion, hapësirat e parkingjeve, rrugëve interne, shtigjeve për këmbësorë, hapësirat e lojërave për fëmijë. Hapësirat e rezervuara komunale për infrastrukturë (ujësjellës, kanalizim, ngrohje, rrymë, telefoni, sistemi kabllorik).

Kushtet e veçanta

Parcelat të bashkohen me parcelat fqinje për të krijuar kushtet e domosdoshme për ndërtimin në zonën ku lejohet ndërtimi i përmbajtjeve afariste. Arkitektura e objekteve duhet të jetë në harmoni me objektet ekzistuese të bllokut dhe zonës në tërësi.

Numrat e parcelave që përfshihen brenda bllokut 1a:

7448, 7570, 7437/1/7/17/18/19, 7573, 7574, 7569, 7575, 7576, 7577/1.





Llogaritja e kapaciteteve në bazë të koeficienteve për sipërfaqen e destinuar për ndërtim në kuadër të **Bllokut 1a**:



Tabela e llogaritjes së parametrave urban		
Zona		1
Blloku		1a
Sipërfaqja ku lejohet ndërtimi (1a) (m ²)		391
Shfrytëzimi i nëntokës (%)		100%
Indeksi i shfrytëzimit të sip. ndërtimore (%)		100%
Etazhiteti i lejuar (S+P+2)		4
Shputa (m ²)		391
Sipërfaqja totale ndërtimore (m ²)		1564
Raporti	Banim (%)	75%
	Afarizëm (%)	25%
Banimi	Sipërfaqja totale (m ²)	1173
	Numri i vendparkimeve (1 vendparkim / 1 apartament)	
	Numri i banorëve	47
Afarizmi	Sipërfaqja totale (m ²)	391
	Numri i vendparkimeve (1 vendparkim / 100 m ² afarizëm)	
Vërejtje	Lejohet ndërtimi vetëm i një njësie (lamele) me gabarit dhe etazhitet të njëjtë sikurse objekti fqinjë (objektet në rend)	

Llogaritja e kapaciteteve totale për **Bllokun 1a**:


Totali i parametrave urban		
Zona		1
Blloku		1a
Sipërfaqja totale e bllokut (m ²)		56165
Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë (ISD)		1,9
Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP)		0,3
Raporti	Banimi	62%
	Afarizmi	37%
	Institucione shkollore	1%
Numri i banorëve		2483
Numri i vendparkimeve		638
Shputa (m ²)		18641
Sipërfaqja totale ndërtimore (m ²)		106147
Dendësia e banimit (banorë/ha)		442
Vërejtje		





Plani Rregullues DARDANIA	
Objekti	1/1a
Bloku	1a
Destinimi	Afarizëm (PTK)
Sip. bazë	1378 m ²
Sip. totale e objektit	17918 m ²
Planimetria	
Foto	



Plani Rregullues DARDANIA	
Objekti	2/1a
Bloku	1a
Destinimi	banesor - afarist
Nr i banesave	86
Numri i banorëve	361
Numri i hyrjeve	2
Sip. bazë	1168 m ²
Sip. totale e objektit	14223 m ²
Planimetria	
Foto	





Plani Rregullues DARDANIA	
Objekti	3/1a
Bloku	1a
Destinimi	banesor - afarist
Nr i banesave	45
Numri i banorëve	218
Numri i hyrjeve	4
Sip. bazë	1068 m ²
Sip. totale e objektit	6409 m ²
Planimetria	
Foto	

Plani Rregullues DARDANIA	
Objekti	4/1a
Bloku	1a
Destinimi	afarist
Sip. bazë	2802 m ²
Sip. totale e objektit	8408 m ²
Planimetria	
Foto	



Plani Rregullues DARDANIA	
Objekti	5/1a
Blloku	1a
Destinimi	banesor - afarist
Nr i banesave	158
Numri i banorëve	931
Numri i hyrjeve	4
Sip. bazë	1829 m ²
Sip. totale e objektit	20207 m ²
Planimetria	
Foto	


Plani Rregullues DARDANIA	
Objekti	6/1a
Blloku	1a
Destinimi	sipërfaqe komunikuese - afariste
Sip. bazë	1203 m ²
Sip. totale e objektit	1203 m ²
Planimetria	
Foto	



Plani Rregullues DARDANIA

Objekti	7/1a
Blloku	1a
Destinimi	banesor - afarist
Nr i banesave	18
Numri i banorëve	142
Numri i hyrjeve	3
Sip. bazë	920 m ²
Sip. totale e objektit	3943 m ²

Planimetria




Foto



Plani Rregullues DARDANIA

Objekti	8/1a
Blloku	1a
Destinimi	afarizëm
Sip. bazë	1841 m ²
Sip. totale e objektit	4990 m ²

Planimetria



Foto






Plani Rregullues DARDANIA

Objekti	9/1a
Blloku	1a
Destinimi	Çerdhja "Lulevera"
Etazhiteti	P+0
Sip. totale e objektit	1230 m ²
Nr. i fëmijëve	189
Nr. i punëtorëve	35



Planimetria



Foto



Plani Rregullues DARDANIA

Objekti	10/1a
Blloku	1a
Destinimi	banesor - afarist
Nr i banesave	127
Numri i banorëve	534
Numri i hyrjeve	4
Sip. bazë	1700 m ²
Sip. totale e objektit	16855 m ²



Planimetria



Foto






Plani Rregullues DARDANIA

Objekti	11/1a
Blloku	1a
Destinimi	banesor
Nr i banesave	29
Numri i banorëve	122
Numri i hyrjeve	2
Sip. bazë	716 m ²
Sip. totale e objektit	2867 m ²

Planimetria




Foto



Plani Rregullues DARDANIA

Objekti	12/1a
Blloku	1a
Destinimi	banesor
Nr i banesave	19
Numri i banorëve	80
Numri i hyrjeve	2
Sip. bazë	405 m ²
Sip. totale e objektit	1457 m ²



Planimetria





Foto








Plani Rregullues DARDANIA	
Objekti	13/1a
Bloku	1a
Destinimi	banesor
Nr i banesave	5
Numri i banorëve	26
Numri i hyrjeve	5
Sip. bazë	614 m ²
Sip. totale e objektit	1228 m ²
Planimetria	
Foto	

Plani Rregullues DARDANIA	
Objekti	14/1a
Bloku	1a
Destinimi	banesor – afarist
Nr i banesave	19
Numri i banorëve	80
Numri i hyrjeve	3
Sip. bazë	840 m ²
Sip. totale e objektit	4347 m ²
Planimetria	
Foto	



Plani Rregullues DARDANIA	
Objekti	15/1a
Blloku	1a
Destinimi	sipërfaqe komunikuese – afariste
Sip. bazë	630 m ²
Sip. totale e objektit	1260 m ²
Planimetria	
Foto	

Plani Rregullues DARDANIA	
Objekti	16/1a
Blloku	1a
Destinimi	sipërfaqe komunikuese – afariste
Sip. bazë	2013 m ²
Sip. totale e objektit	2013 m ²
Planimetria	
Foto	



Intervenimet		
Enterieri (hapësirat e përbashkëta)	Të revitalizohen: <input checked="" type="checkbox"/> Hyrja dhe korridoret <input checked="" type="checkbox"/> Gardhi i shkallëve <input checked="" type="checkbox"/> Ashensorët <input checked="" type="checkbox"/> Hapësirat e përbashkëta	Të rivendosen: <input checked="" type="checkbox"/> Tabelat e shpalljeve <input checked="" type="checkbox"/> Sirtarët postar <input checked="" type="checkbox"/> Shenjzimet nëpër kate <input checked="" type="checkbox"/> Pajisjet kundër zjarrit <input checked="" type="checkbox"/> Lirimi i hapës. të përbashkëta
Eksterieri (Fasadat)	Të revitalizohen: <input checked="" type="checkbox"/> Fasadat <input checked="" type="checkbox"/> Ballkonet, lozhat, terrasat <input checked="" type="checkbox"/> Hyrjet dhe atikat <input checked="" type="checkbox"/> Forma, madhësia dhe materializimi i unifikuar i hapjeve <input checked="" type="checkbox"/> Emërtimi i hyrjeve <input checked="" type="checkbox"/> Sanimi i kulmeve të rrafshta - mbulimi me kulme të pjerrëta (7°-10°)	Të rivendosen : <input checked="" type="checkbox"/> Ulluqet horiz. dhe vertikale <input checked="" type="checkbox"/> Interfonat <input checked="" type="checkbox"/> Emërtimi i hyrjeve <input checked="" type="checkbox"/> Qasje për persona me aftësi të kufizuara <input checked="" type="checkbox"/> Montimi i shkallëve për evakuim Të largohen : <input checked="" type="checkbox"/> Përçuesit ajror <input checked="" type="checkbox"/> Antenat satelitore <input checked="" type="checkbox"/> Reklammat pa leje, grafitet
Instalimet	Sanimi dhe mbrojtja e të gjitha instalimeve: <input checked="" type="checkbox"/> Instalimet elektrike <input checked="" type="checkbox"/> Instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit <input checked="" type="checkbox"/> Instalimet e ngrohjes qendrore	
Parteri	Të punohen: <input checked="" type="checkbox"/> Riasfaltimi i rrugëve banimore në kuadër të zonës <input checked="" type="checkbox"/> Rregullimi i trotuareve, shtigjeve, pllatove <input checked="" type="checkbox"/> Punimi i rampave <input checked="" type="checkbox"/> Rigjenerimi e sipërfaqeve gjelbëruese <input checked="" type="checkbox"/> Ulëset <input checked="" type="checkbox"/> Pastrimi dhe mbulimi i pusetave <input checked="" type="checkbox"/> Riaktivizimi i ndriçimit publik <input checked="" type="checkbox"/> Sigurimi i vendkalimeve të mbuluara me priza <input checked="" type="checkbox"/> Rekuizitat dhe rëra për lojërat e fëmijëve <input checked="" type="checkbox"/> Pastrimi dhe vendosja e kontejnerëve (menaxhimi i mbeturinave)	





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PRISHTINËS

Drejtoria i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



ZONA 1

Blloku 1b



LEGJENDA:

Objekte ekzistuese që ruhen Existing conserved objects	Çerdhe (e propozuar) Kindergarden (proposed)
Objekte ekzistuese që rrënohen Destruction of existing objects	Nën/mbi kalim Passage
Zonë ku lejohet ndërtimi Allowed zone to built	Lumi Prishtevka Prishtevka river
Parter / Gjelbërim Path & paving / Green area	Kolektori i lumit Prishtevka Prishtevka river collector
Shesh Plaza	Kufiri i planit rregullues Regulatory plan boundary
Garazhë nëntokësore - gjelbërim dhe lojra Underground garage - green area	Vija rregullative Regulatory line
Gjelbërim Green area	Vija ndërtimore Construction line
Administratë Administration	Kufiri i bllokut Block boundary
Ngrohtorja Central heating	Parcela Parcel
Zgjerim i shkollës School extension	
Zgjerim i shkollës (salla e sportive) School extension (sports hall)	

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E PRISHTINËS/OPSTINA PRISTINA/MUNICIPALITY OF PRISTINA

DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
 THE DEPARTMENT OF URBANISM, CADASTRE AND ENVIRONMENT PROTECTION
 DIREKCIJA ZA URBANIZAM, KATASTAR I OCUVANJE OKOLINE



ZGJIDHJA URBANE

PLANI RREGULLUES "DARDANIA" Regulatory plan "DARDANIA" Regulacioni plan "DARDANIA"		
PËRMBAJTJA SHTOJCA GRAFIKE PËR BLOKUN 1b		
PROJEKTUES 		Nr. i fletes. -

VËRTETON

DREJTORI I DREJTORATIT TË URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
 dipl.ing. SHIQERI SPAHIU

KRYETARI I KUVENDIT KOMUNAL TË PRISHTINËS
 prof.dr. ISA MUSTAFA

Maj 2009



12. TREGUESIT E PËRGJITHSHËM RREGULATIV TË NDËRTIMIT

Blloku 1b

Hapësira për banim, tregti, administratë dhe biznes

Kushtet e përgjithshme

Destinimi: Banim kolektiv, oazë e gjelbëruar, afarizëm, tregti, administratë, funksione përcjellëse (parking, sheshe, hapësira për lojëra të fëmijëve, gjelbrim)

Lejohet: Revitalizimi i fasadës së objekteve kolektive ekzistues. Krijimi i shtigjeve për këmbësorë, oazave gjelbëruese, hapësirave relaksuese, për argëtim dhe këndeve për lojëra fëmijësh. Gjelbrim i lartë amortizues i zhurmës dhe pluhurit. Rregullimi i jashtëm, hapësira të gjelbërta dhe parkingje si dhe shfrytëzimi i hapësirës për parkingjeve, garazhe, rrugëve interne, shtigjeve për këmbësorë, hapësirat e lojërave për fëmijë, hapësirat e rezervuara komunale për infrastrukturë (ujësjellës, kanalizim, ngrohje, rrymë, telefoni, sistemi kabllorik).

Kushtet e veçanta Arkitektura (dukjet) e objekteve duhet të jetë në harmoni me objektet ekzistuese të bllokut dhe zonës në tërësi.

Numrat e parcelave që përfshihen brenda bllokut 1b:

7437/1/7/17/18/19, 7577, 7577/1




Llogaritja e kapaciteteve totale për **Bllokun 1b**:

Totali i parametrave urban		
Zona	1	
Blloku	1b	
Sipërfaqja totale e bllokut (m²)	11489	
Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë (ISD)	1,2	
Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP)	0,2	
Raporti	Banimi	78%
	Afarizmi	22%
Numri i banorëve	511	
Shputa (m²)	1944	
Sipërfaqja totale ndërtimore (m²)	13377	
Dendësia e banimit (banorë/ha)	445	
Vërejtje		




Plani Rregullues DARDANIA

Objekti	1/1b
Bloku	1b
Destinimi	banesor - afarist
Nr i banesave	100
Numri i banorëve	424
Numri i hyrjeve	6
Sip. bazë	1944 m ²
Sip. totale e objektit	13609 m ²



Planimetria



Foto





Intervenimet		
Enterieri (hapësirat e përbashkëta)	Të revitalizohen: <input checked="" type="checkbox"/> Hyrja dhe korridoret <input checked="" type="checkbox"/> Gardhi i shkallëve <input checked="" type="checkbox"/> Ashensorët <input checked="" type="checkbox"/> Hapësirat e përbashkëta	Të rivendosen: <input checked="" type="checkbox"/> Tabelat e shpalljeve <input checked="" type="checkbox"/> Sirtarët postar <input checked="" type="checkbox"/> Shenjzimet nëpër kate <input checked="" type="checkbox"/> Pajisjet kundër zjarrit <input checked="" type="checkbox"/> Lirimi i hapës. të përbashkëta
Eksterieri (Fasadat)	Të revitalizohen: <input checked="" type="checkbox"/> Fasadat <input checked="" type="checkbox"/> Ballkonet, lozhat, terrasat <input checked="" type="checkbox"/> Hyrjet dhe atikat <input checked="" type="checkbox"/> Forma, madhësia dhe materializimi i unifikuar i hapjeve <input checked="" type="checkbox"/> Emërtimi i hyrjeve <input checked="" type="checkbox"/> Sanimi i kulmeve të rrafshta - mbulimi me kulme të pjerrëta (7°-10°)	Të rivendosen : <input checked="" type="checkbox"/> Ulluqet horiz. dhe vertikale <input checked="" type="checkbox"/> Interfonat <input checked="" type="checkbox"/> Emërtimi i hyrjeve <input checked="" type="checkbox"/> Qasje për persona me aftësi të kufizuara <input checked="" type="checkbox"/> Montimi i shkallëve për evakuim Të largohen : <input checked="" type="checkbox"/> Përçuesit ajror <input checked="" type="checkbox"/> Antenat satelitore <input checked="" type="checkbox"/> Reklammat pa leje, grafitet
Instalimet	Sanimi dhe mbrojtja e të gjitha instalimeve: <input checked="" type="checkbox"/> Instalimet elektrike <input checked="" type="checkbox"/> Instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit <input checked="" type="checkbox"/> Instalimet e ngrohjes qendrore	
Parteri	Të punohen: <input checked="" type="checkbox"/> Riasfaltimi i rrugëve banimore në kuadër të zonës <input checked="" type="checkbox"/> Rregullimi i trotuareve, shtigjeve, pllatove <input checked="" type="checkbox"/> Punimi i rampave <input checked="" type="checkbox"/> Rigjenerimi e sipërfaqeve gjelbëruese <input checked="" type="checkbox"/> Ulëset <input checked="" type="checkbox"/> Pastrimi dhe mbulimi i pusetave <input checked="" type="checkbox"/> Riaktivizimi i ndriçimit publik <input checked="" type="checkbox"/> Sigurimi i vendkalimeve të mbuluara me priza <input checked="" type="checkbox"/> Rekuizitat dhe rëra për lojërat e fëmijëve <input checked="" type="checkbox"/> Pastrimi dhe vendosja e kontejnerëve (menaxhimi i mbeturinave)	




REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PRISHTINËS

Drejtorati i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



ZONA 1

Blloku 1c



LEGJENDA:

Objekte ekzistuese që ruhen Existing conserved objects	Çerdhe (e propozuar) Kindergarten (proposed)
Objekte ekzistuese që rrënohen Destruction of existing objects	Nën/mbi kalim Passage
Zonë ku lejohet ndërtimi Allowed zone to built	Lumi Prishtevka Prishtevka river
Parter / Gjelbërim Path & paving / Green area	Kolektori i lumit Prishtevka Prishtevka river collector
Shesh Plaza	Kufiri i planit rregullues Regulatory plan boundary
Garazhë nëntokësore - gjelbërim dhe lojra Underground garage - green area	Vija rregullative Regulatory line
Gjelbërim Green area	Vija ndërtimore Construction line
Administratë Administration	Kufiri i bllokut Block boundary
Ngrohtorja Central heating	Parcela Parcel
Zgjerim i shkollës School extension	
Zgjerim i shkollës (salla e sporteve) School extension (sports hall)	

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E PRISHTINËS/OPSTINA PRISTINA/MUNICIPALITY OF PRISTINA
 DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
 THE DEPARTMENT OF URBANISM, CADASTRE AND ENVIRONMENT PROTECTION
 DIREKCIJA ZA URBANIZAM, KATASTAR I OCUVANJE OKOLINE



ZGJIDHJA URBANE

PLANI RREGULLUES "DARDANIA"
Regulatory plan "DARDANIA"
Regulacioni plan "DARDANIA"

PËRMBAJTJA

SHTOJCA GRAFIKE PËR BLOKUN 1c

PROJEKTUES

LINPROJEKT

Nr. i fletes.

-

VËRTETON

DREJTORI I DREJTORATIT TË URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
dipl.ing. SHIQERI SPAHIU

KRYETARI I KUVENDIT KOMUNAL TË PRISHTINËS
prof.dr. ISA MUSTAFA

Maj 2009



12. TREGUESIT E PËRGJITHSHËM RREGULATIV TË NDËRTIMIT

Blloku 1c

Hapësira për afarizëm, shërbime publike dhe gjelbëruara

Kushtet e përgjithshme

Destinimi: Objekti ekzistues: Ngrohtorja "Termokos". Afarizëm, shërbime publike, oaza të gjelbruara

Tabela e llogaritjes së parametrave urban		
Zona		BK2
Blloku		BK2
Sipërfaqja ku lejohet ndërtimi (m ²)		3334
Shfrytëzimi i nëntokës (%)		70%
Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (%)		40%
Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë		3
Sipërfaqja totale ndërtimore (m ²)		10002
Shputa (m ²)		1334
Destinim	Banim	50%
	Afarizëm (max)	50%
Banimi	Sipërfaqja totale (m ²)	5001
	Numri i vendparkimeve (1 vendparkim / 1 apartament)	
	Numri i banorëve	200
Afarizmi	Sipërfaqja totale max. (m ²)	5001
	Numri i vendparkimeve (1 vendparkim / 100 m ² afarizëm)	
Vërejtje	Etazhiteti i lejuar i ndërtimit	P+9

Llogaritja e kapaciteteve totale për komplet **Bllokun BK2**:

Totali i parametrave urban		
Zona		BK2
Blloku		BK2
Sipërfaqja totale e bllokut (m ²)		16009
Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë (ISD)		2,3
Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP)		0,2
Raporti	Banimi	86%
	Afarizmi	14%
Numri i banorëve		1301
Numri i vendparkimeve		316
Shputa (m ²)		3916
Sipërfaqja totale ndërtimore (m ²)		37130
Dendësia e banimit (banorë/ha)		813
Vërejtje		




Plani Rregullues DARDANIA

Objekti	1/BK2
Blloku	BK2
Destinimi	Banesor-afarist
Nr i banesave	147
Numri i banorëve	617
Numri i hyrjeve	3
Sip. bazë	1155 m ²
Sip. totale e objektit	15260 m ²



Planimetria



Foto




Plani Rregullues DARDANIA

Objekti	2/BK2
Blloku	BK2
Destinimi	Banesor-afarist
Nr i banesave	162
Numri i banorëve	681
Numri i hyrjeve	5
Sip. bazë	1844 m ²
Sip. totale e objektit	17538 m ²



Planimetria



Foto





Intervenimet		
Enterieri (hapësirat e përbashkëta)	Të revitalizohen: <ul style="list-style-type: none"><input checked="" type="checkbox"/> Hyrja dhe korridoret<input checked="" type="checkbox"/> Gardhi i shkallëve<input checked="" type="checkbox"/> Ashensorët<input checked="" type="checkbox"/> Hapësirat e përbashkëta	Të rivendosen: <ul style="list-style-type: none"><input checked="" type="checkbox"/> Tabelat e shpalljeve<input checked="" type="checkbox"/> Sirtarët postar<input checked="" type="checkbox"/> Shenjzimet nëpër kate<input checked="" type="checkbox"/> Pajisjet kundër zjarrit<input checked="" type="checkbox"/> Lirimi i hapës. të përbashkëta
Eksterieri (Fasadat)	Të revitalizohen: <ul style="list-style-type: none"><input checked="" type="checkbox"/> Fasadat<input checked="" type="checkbox"/> Ballkonet, lozhat, terrasat<input checked="" type="checkbox"/> Hyrjet dhe atikat<input checked="" type="checkbox"/> Forma, madhësia dhe materializimi i unifikuar i hapjeve<input checked="" type="checkbox"/> Emërtimi i hyrjeve<input checked="" type="checkbox"/> Sanimi i kulmeve të rrafshta - mbulimi me kulme të pjerrëta (7°-10°)	Të rivendosen : <ul style="list-style-type: none"><input checked="" type="checkbox"/> Ulluqet horiz. dhe vertikale<input checked="" type="checkbox"/> Interfonat<input checked="" type="checkbox"/> Emërtimi i hyrjeve<input checked="" type="checkbox"/> Qasje për persona me aftësi të kufizuara<input checked="" type="checkbox"/> Montimi i shkallëve për evakuim Të largohen : <ul style="list-style-type: none"><input checked="" type="checkbox"/> Përçuesit ajror<input checked="" type="checkbox"/> Antenat satelitore<input checked="" type="checkbox"/> Reklammat pa leje, grafitet
Instalimet	Sanimi dhe mbrojtja e të gjitha instalimeve: <ul style="list-style-type: none"><input checked="" type="checkbox"/> Instalimet elektrike<input checked="" type="checkbox"/> Instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit<input checked="" type="checkbox"/> Instalimet e ngrohjes qendrore	
Parteri	Të punohen: <ul style="list-style-type: none"><input checked="" type="checkbox"/> Riasfaltimi i rrugëve banimore në kuadër të zonës<input checked="" type="checkbox"/> Rregullimi i trotuareve, shtigjeve, pllatove<input checked="" type="checkbox"/> Punimi i rampave<input checked="" type="checkbox"/> Rigjenerimi e sipërfaqeve gjelbëruese<input checked="" type="checkbox"/> Ulëset<input checked="" type="checkbox"/> Pastrimi dhe mbulimi i pusetave<input checked="" type="checkbox"/> Riaktivizimi i ndriçimit publik<input checked="" type="checkbox"/> Sigurimi i vendkalimeve të mbuluara me priza<input checked="" type="checkbox"/> Rekuizitat dhe rëra për lojërat e fëmijëve<input checked="" type="checkbox"/> Pastrimi dhe vendosja e kontejnerëve (menaxhimi i mbeturinave)	



Plani Rregullues DARDANIA					
Objektet për rrënim					
Blloku BK2					
Nr. i objektit	Destinimi	Sip. totale (m ²)	Lokacioni	Planimetria	Foto
3/BK2	Afarist	202			
4/BK2	Afarist	2589			
5/BK2	Banim	177			
6/BK2	Garazhë	24			
7/BK2	Banim	128			
8/BK2	Garazhë	49			



Plani Rregullues DARDANIA					
Objektet për rrënim					
Blloku BK2					
Nr. i objektit	Destinimi	Sip. totale (m ²)	Lokacioni	Planimetria	Foto
				0 10 20 30 40 50	
9/BK2	Banim	292		S+P+1 	
10/BK2	Afarist	93		P+0 	
11/BK2	Banim	258		S+P+1 	
12/BK2	Banim	503		S+P+1 	

Rekapitullim		
Kostoja financiare e rrënimi të objekteve në Bllokun BK2		
Rrënimi i objekteve	Sipërfaqja totale [m ²]	Kostoja financiare [€]
Banimore: (5,6,7,8,9,11,12 / BK2)	1430	-
Afariste: (3, 4, 10 / BK2)	2884	-
Totali	4314	-



13. TRAFIKU DHE TRANSPORTI

Rekomandimet e përgjithshme:

- Të ndërtohet lidhja me Lagjen e Kalabrisë përmes nënkalimit për këmbësor, pranë Ngrohtores së Qytetit (në mes të Zonës 1c dhe 1e). Lëvizja e këmbësorëve përmes nënkalimeve është planifikuar edhe pranë stacionit të autobusëve ku është një frekuentim i theksuar i udhëtarëve, që do të mundësonte integrimin në sistemin e ri të transportit rrugor dhe hekurudhor urban.
- Funkcionimi efikas i komunikacionit në lagjen Dardania do të mundësohet edhe me nënkalimet të cilat janë përcaktuar nëpër bulevardet (Bulevardi i Dëshmorëve dhe Bill Clinton). Nënkalimet mund të jenë me përmbajtje afariste-tregtare dhe funksione tjera publike.
- Të riasfaltohen rrugët të cilat janë të asfaltuara, sidomos ato primare.
- Të gjitha parkingjet ekzistuese në lagjen "Dardania" duhet të sinjalizohen sipas rregullave të parapara.
- Të ndërtohen trotualet në dy anët e rrugëve primare.
- Të vendosen shenjat e emërimit të rrugëve.
- Të bëhet ndriçimi i tunelit dhe ato vërejtje që i cekëm më lartë gjatë përshkrimit të gjendjes ekzistuese.
- Të vendosen pengesat e shtruara në rrugë, sipas standardeve të parapara të cilat pamundësojnë lëvizjen me shpejtësi të madhe.
- Të caktohen kahjet si të rrugëve primare ashtu edhe sekondare sepse mundësitë teknike ekzistojnë.
- Të vendosen shenjat në kryqëzimin e rrugës "Llazar Vuçkoviç" dhe "Iljaz Kodra".
- Shfrytëzimi i sipërfaqeve të pashfrytëzuara për parkingje.
- Në rrugët të cilat janë të ngushta, duhet të formohet xhepi i cili mundëson përballëkalim të sigurtë.
- Shumica e rrugëve që nuk kanë dalje të sinjalizohen me shenjën e komunikacionit pa dalje.
- Të bëhet zgjerimi i rrugëve ekzistuese sipas profileve të dhëna
- Të bëhet vendosja e shtigjeve për biçikleta në rrugën unazore dhe në rrugët tjera sipas profileve të planifikuara të lagjes
- Zhvillimi i transport publik i udhëtarëve në brendi lagjes "Dardania":
 - *Linja 1.* - Fillon nga kryqëzimi i "Bulevardi Bill Klinton" rrugës "Iljaz Kodra" duke vazhduar drejt rrugës "Idriz Gjilani" dhe do të vazhdonte deri te "Sheshi Sali Çeku" ku do të lidhej prapë më "Bulevardin Bill Klinton".
 - *Linja 2.* - Transporti publik do të zhvillohej nga "Bulevardi i Dëshmorëve", "28 Nëntori", "Iljaz Kodra", "Rexhep Mitrovica", "Sadik Zeneli", "Lekë Dukagjini", prapë kthehemi anasjelltas nga rruga "Iljaz Kodra".
- Të lirohen hapësirat e uzurpuara në garazhat e përbashkëta sipas PDU
- Për shkak të evitimit të zhurmës të shënohen pjesët rrugore me shpejtësi të kufizuar të lëvizjes së automjeteve (Zona me tempo 30)



- Përmes studimit dhe trajtimit të unazës perëndimore, me anën e projektit të veçantë të mobilitetit, të zgjidhet qasja në stacionin e autobusëve duke pas parasysh trajtimin dhe integrimin e transportit hekurudhor në sistemin e komunikacionit në harmoni me Planin Strategjik të Prishtinës (2004-2020).
- Zgjidhja e parkimit të automjeteve të bëhet edhe përmes garazhimeve nëntokësore në pjesët e planifikuara me këtë Plan Rregullues. Garazhet nëntokësore duhet të trajtohen nga aspekti i kyçjes në infrastrukturën e qytetit (instalimet elektrike, ujit dhe kanalizimit). Po ashtu në garazha nëntokësore duhet të trajtohen: ajrosja, pajisjet automatike për hyrje-dalje, shenjzimi horizontal dhe vertikal, sistemi i kontrollit dhe informimit digjital duke përfshi edhe hapësira tjera sipas normave dhe standardeve teknike.
- Rregullimi funksional i trafikut (komunikacionit) në hyrje të tunelit, nga ana e Bulevardit Bill Klinton, të zgjidhet përmes regjimit të rregulluar të komunikacionit

Tabela e mëposhtme prezanton kapacitetet e vendparkimeve në lagjen Dardania:

Blloku	Gjendja ekzistuese		Gjendja e planifikuar		
	Parking	Garazha ekzistuese	Garazha nëntokësore	Parking	Garazha
1a	115	249	260	3	11
1b					
1c				38	151
1d	25			78	314
1e					
2	112		282		
3a				19	76
3b		86			
4a					
4b	6		279		
5a		74			18
5b	84				
5c	14				
6a			797		
6b		86			
7a	58	84			
7b					
8a	55			15	61
8b				59	237
8c			373	46	186
8d	48			125	502
9a	38			6	
9b			434		
9c					
BK1	144	84			
BK2	8		239	21	85
Totali	707	663	2664	410	1641



14. RRJETI ELEKTROENERGJETIK DHE TELEKOMUNIKUES

Rekomandimet e master planit për zhvillimin e sistemit distributiv të Kosovës deri më vitin 2015, që përfshinë:

- Eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV
- Kalimin nga rrjeti distributiv 10 kV në rrjetin distributiv 20kV
- Zëvendësimin e TS 10/0.4 kV me ato 20/0.4kV
- Zëvendësimi i linjave ajrore 230/400V me kablllo bistek apo edhe kablllo nëntokësore.

Lagjia "Dardania" në aspektin energjizimit në kuadër të urbanizmit të qytetit është e planifikuar dhe paraparë qysh më herët. Trafostacionet 10/04kV, qysh në planifikimet e mëhershme janë të parapara dhe kanë lokacionin e caktuar në kuadër të ndertesës.

Po ashtu këto trafostacione janë të kyçura me kabëll IPO 13 me seksion 95, 120 ose 150mm². Për furnizim të mirë edhe të pandërprerë, këto trafostacione janë të lidhura në unaza me njeri tjetrin, me mundësinë e furnizimeve të dyanshme nga dy dalje. Shumica e trafostacioneve e kanë transformatorin e fuqisë 1000kVA dhe 630kVA.

Në muajin me të ftohtë të janarit 2006, Lagjia "Dardania" ka tërhequr 13.62MVA, ndërsa muajin janar 2007 ka tërhequr 12.675MVA, për shkak se muaji ka qenë më i ngrohtë në krahasim me 2006. Nëse nuk ka nxehtë qendrore nga termokosi kjo ngarkesë rritet për 20%.

Disa nga trafostacionet 10/0.4kV i përballojnë ngarkesat, ndërsa disa prej tyre e arrijnë maksimumin e ngarkesës ose e tejkalojnë atë.

Në qoftë se kjo lagje do të zgjerohet, duhet të parashihet poashtu zgjerimi i ngarkesave dhe zgjerimi i daljeve 10kV.

Trafostacioni Prishtina III 35/10kV është e mbingarkuar dhe në projektet tona të ardhme është paraparë kalimi në nivelin prej 35kV në nivelin 110 /20(10)kV. Për momentin ky trafostacion furnizon lagjen Dardania, Ulpiana, një pjesë të qytezës Pejton, qendrës, Kodrës së Diellit si dhe institutet dhe bibliotekën.

Propozimi është që trafo Prishtina III 35/110 të ndërrohet në 110/20kV, dhe atë me fuqi 2*40 MVA çka edhe bazohet në master planin e KEK si dhe furnizimi i këtij trafostacioni të bëhet me kablllo nëntokësore 2*110kV dhe një kabëll fibër në trasën e paraqitur në vizatim që d.m.th vjen nga Prishtina IV 220/110kV.

Prishtina I 110/35kV gjendet në afërsi të zonës së Amortizatorëve dhe furnizon TS-onet 35/10kV. Ky është i lokalizuar në lokacionin me koordinata të GPS x,y (511085; 4721416).



Gjendja teknike e këtyre TS është e mirë deri diku, nga fakti se shumica e tyre janë të vjetërsuar dhe nuk janë mirëmbajtur si duhet. Pastaj këto TS janë të instaluar për tension 10kV, pa mundësi të eksploatimit në tension 20kV. Linjat furnizuese të TS 10/0.4kV/kV janë të kombinuara shumica prej tyre janë me kablllo nëntokësore 10kV, të gjitha duhet të bëhen nëntokësore. Sipas propozimit do të bëhet ngarkesë e lagjes me TS 1000 kVA dhe atë në zonën 8 (banimi) 3*1000kVA , zonën 1 gjykata 1*1000kVA si dhe zonën 5 te shkolla 1*1000kVA.

Duhet të parashihet ndriçimi publik i rrugëve të parapara në zonën 8 komplet e re në zonën 1d si dhe ndriçimi publik ekzistues duhet të riparohen dhe të mirëmbahen.

Rrjeti telekomunikativ është realizuar me kablllo nëntokësore të shtrirë përgjatë kanaleve kablllore (magjistrave) si dhe pjesës ku është bërë shtrirja e lirë e kablllove telefonik. Vende-vende kabllloja del në shtylla druri prej nga furnizon një numër konsumatorësh. Aktualisht numri i mundshëm i kyçjeve telefonike i përmbush kërkesat e Lagjes sipas të dhënave të PTK-së .

Sipas të dhënave të PTK –së numri aktual i telefonave aktivë në lagjen Dardania është 5862, si dhe ka mundësi të lidhjeve të reja të mjaftueshme.

Vlen të ceket se është duke u punuar në rrjetin e ri të kabllimit optik me qëllim të rritjes së kualitetit të telefonisë (telefonja digjitale), me 7 qendrat e Kosovës që qendrën do ta ketë në objektin PTK-së. Kurse momentalisht përdoren lidhjet radiodifuzive.

Sipas IPKO-së është dhënë shtrirja e fibrave optikë nëpër kanale siç janë paraqitur në harta si dhe nënbazat e IPKO-së. Në të ardhmen mendojnë në zgjerimin e shërbimit të tyre dhe shtrirja e kablllove optikë edhe në brendësi të lagjes Dardania. Shërbimet që i kryejnë janë: Rrjeti i Internetit, TV kabllorë etj. shërbime që i përkasin rrjetave digjitale të kompjuterëve. Të njëjtin shërbim e kryejnë edhe firma Kujtesa.

Vërejtje për të dy firmat që merren me shpërndarjen e rrjetit digjital, kabllimi i shumicës së linjave është bërë prej një ndërtese në ndërtesë tjetër, e pastaj lagjet janë lidhur me lagje tjera duke kaluar rrugët kryesore, si rrjetë merimange, duhet zgjedhje me shtrirje të kablllove nëntokësore.

15. NDRIÇIMI

Në projektimin e rrugëve është përcaktuar edhe mënyra e ndriçimit artificial. Ndriçimi artificial nuk duhet të verbojë e as të pengojë shikimin. Një fenomen tjetër i dëmshëm që shkaktohet nga ndriçimi jo i mirë i rrugëve është ai i reflektimit të dritës, i cili është i rrezikshëm, sidomos kur rrugët janë të lagura. Për të pasur një ndriçim sa më të njëtrajtshëm, ndriçuesit duhet të jenë sa më lart sipërfaqes së tokës. Lartësia e shtyllave elektrike ndryshon nga 30 m të trotuareve deri 12 m dhe largësia ndërmjet tyre 8-60 m.



Shtyllat të vendosen 1.0 - 1.5 m larg nga bordurat. Vendosja e tyre duhet të shkojë sipas ritmit të drunjëve. Mënyra e ndriçimit varet nga gjërësia e rrugëve. Për rrugë me gjerësi deri në 12 m ndriçuesit vendosen vetëm në një anë të rrugës. Për rrugë me gjerësi deri 18 m ndriçuesit varen mbi rrugë dhe për gjerësi mbi 40 m ndriçuesit vendosen në të dy anët e rrugëve. Ndriçimi në kryqëzimin e rrugëve duhet të jetë më i fuqishëm se ndriçimi i rrugës që kryqëzohet. Ndriçimi në këto nyje mund të jetë i ndryshëm nga ai i rrugëve. Ndriçimi i shesheve duhet të jetë 50 % më i fortë se ai i rrugëve që hyjnë në të.

Treguesit e përafërt të ndriçimit të rrugëve janë:

- për rrugë kryesore qytetesh 4-8 luks/m²
- për rrugë banimi 1-2 luks/m².

16. RRJETI TERMOENERGJETIK

Furnizimi i ngrohjes qendrore në objektet e banimit dhe objektet afariste bëhet nga Ngrohtorja e Qytetit "TERMOKOS", Prishtinë.

Pregaditja e ujit të nxehtë bëhet me kaldanë ngrohëse e cila punon me lëndë djegëse mazut.

Furnizimi me ujë të nxehtë i këmbyesve të objekteve bëhet me $t=140$ °C furnizim, ndërsa kthimi me 60 °C.

Furnizimi i objekteve bëhet me anë të gypave të cilët i furnizojnë këmbyesat e nxehtësisë të cilët janë të montuar në bodrumin e objekteve temperatura në këmbyes është 90 °C / 70 °C .

Prej këmbyesve me anë të pompave bëhet shpërndarja e ngrohjes qendrore nëpër objektet e banimit dhe objektet afariste.

Sipas burimeve të njerëzve kompetentë të Ngrohtores së Qytetit, në tërë lagjen "Dardania" është bërë ndërrimi i këmbyesve të vjetër me ata të rinj të tipit ALFA-LLAVAL, të prodhuesve suedezë. Është bërë ndërrimi i gypave me paraizolim në një pjesë të rrjetit që ka qenë i dëmtuar.

Shpërndarja e energjisë bëhet me sistemin dy gyporë të mbyllur.

Sipas burimeve nga Ngrohtorja e Qytetit, sistemi i gypave - rrjeti shpërndarës është pjesërisht në gjendje të mirë, por është i domosdoshëm sanimi i tyre.

Temperatura në objektet e banimit është e kënaqshme, mirëpo ka humbje për shkak të amortizimit të objekteve, si p.sh. dritaret, izolimi i objekteve etj. Në të ardhmen duhet të parashihet izolimi i objekteve të banimit me izolim të mirë, sipas standardeve evropiane, me qëllim që humbjet termike të jenë më të vogla. Humbje të vogla ka në rrjetin e sistemit të ngrohjes nëpër objekte të banimit, sepse janë të dëmtuar gypat ku duhet të bëhet sanimi i tyre. Pusetat duhet të përmisohen për shkak të sigurisë.



Dispozicioni i rrjetit të shpërndarë të ngrohjes në objektet e banimit mundë të shihet në planet e dhëna nga "Termokos" ku në të shihen të gjitha shpërndarjet e rrjetit nëpër lagjen "Dardania" dhe kapacitetet për secilin nën-stacion të montuar në bodrumet e objekteve.

17. INFRASTRUKTURA HIDROTEKNIKE

I. RRJETI PËR FURNIZIM ME UJË TË PIJES

Për të bërë planifikimin e rrjetit të ujësjellësit në lagjen "Dardania" jemi bazuar në:

- në Planin Detaj Urbanistik të vitit 1973
- të dhënat nga anketimi me qytetarë
- të dhënat e marra nga kompania "Ujësjellësi Prishtina"

Sipërfaqja e lagjes:

Sipas matjeve të bëra nga ekipet në terren del se sipërfaqja e tërësishme e kësaj lagjeje është ~ 60 ha.

Numri i banorëve:

Sipas një ankete të bërë me banorët mendohet se në këtë lagje momentalisht jetojnë N=13 381 banorë (sipas profilit), përvetësojmë 20 000 banorë

Furnizimi:

Lagja "Dardania" sipas shënimeve të marra nga kompania e ujit furnizohet nga liqeni i Badovcit dhe liqeni i Batllavës.

Norma e harxhimit të ujit:

Norma e harxhimit të ujit për një banor merret :
N=200l/b/dite

Koeficienti i jonjëtrajshmërisë:

K=1.55
Qmes=53.81(l/s)

Humbjet në rrjetë:

Humbjet në rrjetë merren gjithsej 20% të prurjeve të përgjithshme:
H=10.76 (l/s)

SIPERFAQET E GJELBRUARA

- | | | | |
|---|------------------|--------|-------------------|
| 1. Sipërfaqet dekorative të qytetit | l/m ² | 14 -18 | |
| 2. Sipërfaqet e mbjella me lule | l/m ² | 14-18 | |
| 3. Larja e shesheve në ditë të nxehtë | l/m ² | 2 | |
| 4. Drunjët e porsambjellë në tre vitet e para (me 6 -10 ujitje në ditë) | | | një dru
18 -27 |



Për shkak të sipërfaqeve të mëdha të gjelbëruara, dhe në anën tjetër duke marrë në konsideratë harxhimet e mëdha të ujit për pije preferohet që për këto sipërfaqe, auto larje, larjen e rrugëve dhe trotuareve të gjendet mundësia e hulumtimit të ujërave nëntokësore. Këto ujëra të kapen me anën e shpimeve dhe të përdoren për destinim të caktuar.

Ne baze të gjithë kësaj del se sasia e nevojshme për të furnizuar me ujë të pijes është:
Qmes/ditë=68.031(l/s)

Konkludim:

Në bazë të shënimeve të sipërshënuar konkludojmë se :diametri Ø350mm i plotëson kushtet e nevojshme për të furnizuar me ujë këtë pjesë të qytetit. Gypat duhet të ndërrohen prej gypave të asbest çimentos në gypa plastike (PE ose te ngjashëm) duke e përfshirë edhe ndryshimin e pusetave si dhe pjesëve fazonike.

II. RRJETI PËR LARGIMIN E UJËRAVE FEKALE DHE ATMOSFERIKE

Për planifikimin e rrjeteve hidroteknike jemi bazuar:

- në Planin Detaj Urbanistik të vitit 1973
- të dhënat nga anketimi me qytetarë
- të dhënat e marra nga kompania e ujit "Ujësjellësi Prishtina"

Kullimi i ujërave sipërfaqësor nga parcelat bëhet me ramje të lirë nga rigollat, respektivisht kah rruga me ramjen më të vogël prej 1.5 %. Ujërat sipërfaqësor nga një parcelë ndërtimore nuk mund të drejtohen kah parcela tjetër, përveç në raste kur një zgjidhje e tillë është e përcaktuar me plan.

Ujërat fekale

Nga të dhënat e sipërshënuara është parë se 80% të sipërfaqes së tërësishme të rrjetit të kanalizimit fekal është e kombinuar d.m.th. ujjrat fekale janë të përziera me ujra atmosferike.

Rekomandohet që:

Të gjitha këto rrjete duhet të ndahen (rrjeti i kanalizimit fekal dhe rrjeti i kanalizimit atmosferik).

Lartësia në mes të pusetave sipas rregulloreve për diametra të ndryshëm duhet të jenë:

Nr.	Diametri i jashtëm i gypave (mm)	Lartësia ne mes pusetave (m)
1.	125	35
2.	150-600	50
3.	700-1400	75
4.	më e madhe se 1500	125 m



Sipas shënimeve të marra nga kompania “Ujesjellësi Prishtina” shihet se e tërë lagjja është e përfshirë me rrjetë të kanalizimit fekal.

Lloji i materialit

Rrjeti për largimin e ujërave fekale është i punuar më gypa të beton armesë me diametra të ndryshëm. Gjendja ekzistuese e kanalizimit fekal mund të konstatohet e mjerueshme. Marrë në një përqindje (sipas shënimeve të marra nga Ujesjellësi afër 80% e kanalizimit fekal është i përzier me kanalizimin atmosferik).

Vërejtje:

Është e detyrueshme që të bëhet ndarja e kanalizimit fekal dhe atmosferik. Përveç kësaj propozohet që të bëhet edhe ndryshimi i gypave prej gypa BA (beton arme) në gypa polietileni.

Pusetat e rrjetit të kanalizimit

Sipas asaj çka është parë e analizuar në terren del se shumica e puseta të kanalizimit fekal janë të shkatërruara. Arsyeja e shkatërrimit është:

- Marrja e kapakëve të gizës.
- Disa puseta janë të shkatërruara edhe gjatë periudhës 1999 e këtej.

Vërejtje

Është e detyrueshme që të bëhet rindërtimi/ndërtim i pusetave, si dhe vendosja e kapakëve të gizës.

Rekomandimet:

- Në të gjitha vendet ku nuk përshtaten këto të dhëna duhet që të shtohet ose largohet numri i pusetave.
- Në 80% të pusetave egzistuese që iu mungojnë kapakët dhe shkallët për zbritje duhet që të plotësohen me kapak dhe shkallë të reja. Që të kemi me pak probleme me kapakë rekomandojmë që nga kompania që merret me prodhimin e këtyre kapakëve në pjesën e sipërme të kapakut të shkruhet:
 - numri i kapakut
 - rruga në të cilën është i vendosur ai kapak. Në të ardhmen do të jetë lehtësim për organet kompetente që merren me identifikimin e këtyre kapakëve.
- Rekomandohet që për shkak të pusetave të hapura nga pakujdesia e qytetarëve është bërë hedhja e mbeturinave dhe nga ndërtimet e shumta të shikohet mundësia e pastrimit të rrjetit të kanalizimit.
- Në të gjitha rrugët që do të propozohen si të reja paraprakisht duhet të bëhet zgjidhja e rrjetit të kanalizimit atmosferik gjegjësisht edhe atij fekal.
- Rekomandohet të bëhet vendosja e WC-ve publike në vendin ku është paraparë sipas Planit Urban të vitit 1973



- Nëse të gjitha këto plotësohen diametri ekzistues i plotëson nevojat për këtë numër të banorëve.
- Është e preferueshme që për shkak të ndryshimit të teknologjisë dhe duke parë efikasitetin dhe përparësitë e gypave të polietilenit të brinjëzuar që edhe në këtë pjesë të qytetit gypat e beton armesë të ndërrohen me gypa PE.

III. POZITA E LUMIT PRISHTINA

Planet Rregulluese të aprovuara të lagjeve që e tangjentojnë lagjen “Dardania”, lumin Prishtina e kanë trajtuar dhe si përfundim kanë propozuar që shtrati i saj të rihapet. Prandaj segmenti i lumit Prishtina (~ 350 m’) që kalon nëpër territorin e lagjes “Dardania” sipas zgjidhjes urbane parashihet të rihapet.

Profili i shtratit të rregulluar të lumit do të jetë identik me ato të lagjeve që e tangjentojnë lagjen “Dardania”.

REZYME - INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Instalimet ekzistuese të infrastrukturës teknike, në shumicën e rasteve janë në një shkallë të lartë të amortizimit, disa prej tyre të pa instaluara, kurse disa janë në proces e sipër sipas planeve zhvillimore të organizatave gje gjegjëse.

Ndërtimet e reja paraqesin imperativ për instalime të reja të infrastrukturës teknike duke pasur parasysh ruajtjen e resurseve energjetike ekzistuese të vendit dhe ruajtjen e ambientit.

- Instalimet e ujësjellësit – Vendosja e sistemit të ri
- Instalimet e kanalizimit – Vendosja e sistemit të ri
- Akumulimet e ujërave atmosferik – Punimi i kolektorëve dhe vendosja e ujëmbledhësve
- Instalimet e ngrohjes – Programi i ruajtjes së energjisë dhe ambientit
- Instalimet e rrjetit kabllorik – Largimi i të gjitha antenave satelitore
- Instalimet e internetit – sistem qendror i instalimeve
- Ndriçimi publik - funksional, dekorativ dhe reprezentativ

18. GJELBËRIMI

Gjelbërimi duhet që ti përgjigjet kushteve konkrete të lagjes, sipas llojit dhe gjerësisë së rrugëve, nga ngarkesa e lëvizjes, nga etazhiteti, lloji dhe karakteri i tyre, nga faktorët e klimës si dhe nga kushtet sanitaro-higjenike.

Si faktor kryesor që ndikon në mënyrën e projektimit të gjelbërimit rrugor kemi marrë orientimin e rrugëve ekzistuese të lagjes “Dardania”.

Gjelbërimi i rrugëve të orientuara lindje-perëndim është mirë të bëhet në këtë mënyrë:



- në anën veriore të rrugës, mund të mos mbillen drunj.
- Në anën jugore, drunjt duhet të mbillen në të dy anët e trotuarit për të mbrojtur këmbësorët nga rrezet e dëmshme të diellit në ditët e nxehta.

Gjelbërimi i rrugëve të orientuara veri-jug, të bëhet në këtë mënyrë: në anën perëndimore të rrugës të mbillen në të dy anët e trotuarit afër banesave drunj të lartë dhe të mëdhenj. Në anën lindore mund të mbillen një rresht me drunj ndërmjet trotuarit dhe pjesës së kalimit. Brezat e gjelbërimit të vazhdueshëm gjatë gjithë trotuarit duhet të kenë një gjerësi për një rresht jo më të vogël se 1.5-2.0 m dhe për dy rreshta jo më të vogla se 5.0 m, ndërsa për shkurret brezi i gjelbërt duhet të jetë i gjerë 0.8-1.50 m. Lloji i gjelbërimit duhet të zgjidhet në varësi të arkitekturës dhe lartësive të banesave. Ritmet dhe largësia ndërmjet drunjve duhet të merret e tillë që të mos mbulojë krejtësisht fasadat e objekteve, por duhet që, me formën dhe madhësinë e tyre të theksojnë vlerat arkitektonike. Drunjtë duhet të jenë të tillë që të mirëmbahen lehtë dhe ti përshtaten kushteve klimatike të vendit. Drunjtë duhet të jenë fidane dyvjeçare. Ndër drunjët që përdoren më së shumti për shëtitore janë: bliri, gështenja e egër, pisha e butë, ahu etj; ndërsa për rrugë banimi janë: pisha e butë, shelgu, robinja etj.

Llojet e gjelbërimit



Tilia paltyphylia



Populus nigra italica
Plepi



Platanus acerifolia



Tilia tormentosa



Aesculus hippocastanum
Gështenja e egër



Carpinus pyramidales
Plepi



Fagus sylvatica
ahu



Acer platanoides



Acer negunda
Panja



Fraxinus excelsor pendula
Frashëri



Gledistia triacanthos



Salix babylonica
Shelgu lotues



Betula youngii



Abies alba
Bredhi



Pinus pinea
Pisha e butë



Rekomandimet:

- Mirëmbajtje më e mirë qoftë nga kompania publike, banorët apo pronarët e lokaleve afariste.
- Sensibilizimi i banorëve rreth mbrojtjes së ambientit.
- Inventarizimi i drunjtë ekzistues dhe krijimi i një baze të të dhënave rreth gjelbërimit të lartë.
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbërua dhe harmonizimi i tyre.
- Formimi i tampon zonave përreth sipërfaqes kufizuese të “Dardanisë”.

19. DISPOZITAT PËR TRAJTIMIN E MBINDËRTIMEVE

Mbindërtimi i banesave, në vështrim të këtij plani rregullativ, konsiderohet ndërtimi i një ose më shumë banesave në ndërtesë e që me ndërtesën ekzistuese përbëjnë tërësinë ndërtimore, si dukuri që mori hov menjëherë pas viteve të luftës (1999).

Për mbindërtimet dhe shndërrimet duhet të hartohet një Studim dhe Hulumtim i veçantë i tyre, në bazë të të cilit Komuna nxjerr vendimet lidhur me kushtet, mënyra dhe procedura për trajtimin.

Trajtimi i mbindërtimit të banesave bëhet sipas këtyre kushteve :

- Që ndërtesa të mos jetë e ndërtuar deri në lartësinë e paraparë me plan rregullativ dhe i përgjigjet kushteve urbano – teknike të ndërtimit për lejimin e ndërtimit apo legalizimin e ndërtimit të kryer.
- Se mbindërtimi deri në lartësinë e paraparë mund të lejohet apo mund të legalizohet pa rrezikimin e stabilitetit të ndërtesës.
- Se mbindërtimi (lejimi apo legalizimi) nuk do të vështësoi shfrytëzimin e pjesëve të caktuara të ndërtesës ekzistuese për qëllimet që duhet tu shërbejnë dhe kushtet tjera të shfrytëzimit të ndërtesës ekzistuese.
- Se mbindërtimi është i arsyeshëm dhe në pajtim me destinimin e ndërtesës dhe se ndërtesa pas përfundimit të mbindërtimit si tërësi do ti plotësoi kushtet bashkëkohore të banimit dhe shfrytëzimit.
- Se mbindërtimi nuk i keqëson dukshëm kushtet e banimit të shfrytëzuesve të banesave në ndërtesën në të cilën duhet të trajtohet mbindërtimi .

Trajtimi i mbindërtimeve nuk duhet të trajtohet veç e veç por duhet të bëhet në tërësinë e ndërtesës ose bllokut të përbërë nga dy a më shumë ndërtesa me respektim të trajtimit të paanshëm dhe të barabartë dhe kostos më të ulët për çështje të përbashkëta si:



- Elaborati i analizës statike nga subjekti përkatës profesional dhe i licencuar për mosrezikimin e stabilitetit të objektit të mbindërtuar apo që do të pasojë mbindërtimi
- Inkorporimi i plotë i mbindërtimit në objektin ekzistues (materializimet , ngjyrat, silueta urbarkitektonike etj.)

20. INTERVENIMET DHE RINOVIMET

Objekte ekzistuese të banimit kolektiv , nga aspekti socialo-ekonomik të rinovohen në frymë dhe koncepte të reja me standarde teknike dhe fizikë ndërtimore sipas standardeve të reja.

Objektet e rinovuara të pajisen me të gjitha llojet e instalimeve të reja, me funksionim të rregullt të ashensorëve, mundsish të garazhim nëntokësor, sipërfaqe për lojë të fëmijëve si dhe përmes gjelbërimit të mbrohen nga zhurma.

SITUATA E PROJEKTUAR

• Numri i i banorëve	19 527
• Numri i banorëve për hektar	374
• Sip. e trolit të ndërtuar	119 878 m ² ose 22,9 %
• Sip. nën Rrugë	71 232 m ² ose 13,6 %
• <u>Sip. e lira</u>	<u>331 639 m² ose 63,4 %</u>

Sipërfaqja bruto e lagjes 573 542 m² (aksi rrugor:
bulevardi / unaza)

Sipërfaqja e lagjes 522 749 m²

Objektet të projektohen me etazhitet sipas karakterit të tyre me qëllim të shfrytëzimit racional të tokës ndërtimore dhe koherencës urbane si një qendër bashkëkohore.

- Objektet e banimit kolektiv - etazhiteti sipas Indeksit të sipërfaqes së dyshemesë (ISD) dhe Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP) - (në Zonën 8; 9a dhe BK2).
- Objekti i administratës - etazhiteti i tyre të përcaktohet sipas projekteve arkitektonike që do të dalë si rrjedhojë e detyrës projektuese. Trulli 2.20 ha. (në Zonën 1d).
- Objektet afariste & administrative - etazhiteti sipas (ISD) - Indeksit të sipërfaqes së dyshemesë dhe (ISHP) - Indeksi i shfrytëzimit të parcelës. (në Zonën 1d;BK2)
- Objekte shkollore (3a dhe 5b)
- Objektet e Çerdheve - ndërtesa e çerdhes me etazhitet deri P+0 (në Zonën 3a dhe 9a).
- Objekti i bibliotekës (blloku 5b)



- Sheshi, objekti i Qendrës - kompleks multidisiplinar (galeri, kinema, etj.). (Blloku 8d).
- Hapësira për sport, rekreim - terrene të hapura të sporteve etj. (në Zonën 4a).
- Garazhimet nëntokësor / gjelbërim dhe loja – (në Zonat 1a,1d, 2, 4b, 6a, 8, 9b dhe BK2).

21. PLANI I PARCELIMIT DHE RIPARCELIMIT

- Plani i parcelimit dhe riparcelimit determinojnë kushtet e rregullimit hapësinor, format që mundësojnë ndërtimin, karakteristikat dhe trasimin e infrastrukturës rrugore dhe lidhjet me infrastrukturën teknike (energjia elektrike, ujësjellësi, kanalizimi, ngrohja qendrore, lidhjet kablovike televizive, interneti, telefonia etj)
- Kushtet për rregullimin e hapësirës janë ekuivalente me kushtet e lokacionit të përcaktuara sipas LPH dhe kanë të bëjnë me :
 - (a) Formën dhe madhësinë e ngastrës ndërtimore;
 - (b) Mënyrën e shfrytëzimit apo shfrytëzimin e autorizuar të ngastrës ndërtimore;
 - (c) Rregullat e vendosjes së ndërtesave në ngastrën ndërtimore;
 - (d) Rregullat për kyçjen e ndërtesës në rrjetin e infrastrukturës teknike;
 - (e) Masat për mbrojtjen e mjedisit dhe vlerave natyrore, kulturore dhe të trashëgimisë;
 - (f) Kushtet tjera të përcaktuara me plane urbane dhe hapësinore si (largimi i ndërtesave dhe riaftësimi i ngastrave, elaboratet gjeomekanike).

22. NORMAT DHE STANDARDET TEKNIKE PËR ZHVILLIM URBAN

Normat, rregullat, dhe standardet e projektimit urban janë plotësimi teknik dhe praktik i domosdoshëm dhe si të tilla janë të detyrueshme për të gjitha organizmat projektuese dhe hartuese nga sfera e planifikimit hapësinor rregullues dhe studimeve urbane.

Elementet perberese te zones se trajtuar me plan rregullativ janë :

- A) terrenet e banimit
- B) terrenet shoqërore
- C) terrenet e gjelbërta
- D) terrenet sportive dhe hapësirat për lojë fëmijësh
- E) rrugët, vendqëndrimet dhe sheshet (sipërfaqet e lira)



A) Në terrenet e banimit përfshihen njësitë urbane të banimit dhe rrugët e mbrendshme midis tyre . Pjesë përbërse e tyre janë edhe parcelat e çerdheve, kopshteve, shkollave fillore dhe shërbimeve të përditshme tregtare dhe komunale.

Terenet e banimit ndahen në njësi strukturore urbane në mvarshmëri të hapësirës territoriale dhe numrit të banorve. Njësitë strukturore urbane të tereneve të banimit janë:

- grup banimi
- bllok banimi
- kompleks banimi
- lagje banimi

Në mvarshmëri të pikëvështrimit nga madhësia territoriale dhe numri i popullatës mund të analizohen parametrat e zhvillimit urban kurse e përbashkëta e të gjithave është se sipërfaqe ndërtimi maksimalisht duhet të jetë 4.5 m² / banor.

Grup banimi është njësi më e vogël strukturore urbane me popullatë deri në 1.000 banorë dhe sipërfaqe deri në 1,5 Ha me S bruto= 15.5 -16 m² / banor.

Blloku i banimit është njësi strukturore urbane e përbërë prej 3- 4 grupe banimi me popullatë prej 3000 - 4000 banorë dhe sipërfaqe 6 - 8 ha me S bruto= 20 m² / banor.

Kompleksi i banimit është njësi strukturore urbane e cila përbëhet nga disa blloqe banimi me popullatë prej 6000 - 8000 banorë dhe sipërfaqe 16 - 20 ha.

Lagje banimi është njësi urbane më e madhe e cila përbëhet nga dy komplekse banimi me popullatë prej 12-16 mijë banorë dhe sipërfaqe 32 - 40 ha.

Në përbërje të saj ka shërbime të përqendruara tregtare, komunale, sociale, kopësht, çerdhe, dy shkolla fillore, një shkollë të mesme, parku i lagjes, terene sportive të të gjitha grup moshave, shërbimi shëndetësor dhe administrativ, sallë koncertesh, biblioteke etj.

B) Në terrenet shoqërore përfshihen objektet e çerdheve, kopshteve dhe shkollat. Treguesit normativ për objektet shoqërore janë: 2.0 m² / 1 fëmijë – nxënës kurse sipërfaqet e nevojshme për parcelat e tyre mund të jenë:

- Parcelat e çerdheve dhe kopshteve 0,3 - 0,4 ha për një çerdhe ose kopësht
- Parcelat e shkolles fillore 0,6 – 1.0 ha.
- Bllokut të banimit për popullatën e tij i duhet një çerdhe dhe një kopësht
- Kompleksit të banimit për popullatën e tij i duhen dy çerdhe ,dy kopshte dhe një shkollë fillore.



C) Në terrenet e gjelbërta bëjnë pjesë :

- sipërfaqet e parqeve apo lulishteve të grupit të banimit 3.0 -4.0 m² / banor
- sipërfaqet e parqeve apo lulishteve të lagjes së banimit 1.0 -2.0 m² / banor
- sipërfaqet e gjelbërimit rrugor dhe brigjeve ujore 1.0 m² / banor
- sipërfaqet e gjelbërimit të objekteve shoqërore 2.0 m² / banor

D) Në terrenet sportive dhe hapësirat për lojë fëmijësh bëjnë pjesë sipërfaqet e nevojshme për terene sporti sipas grupmoshave dhe hapësirat për lojë fëmijësh :

- për bllok banimi sipërfaqe për terene sporti 0,5 m² / banor
- për kompleks banimi sipërfaqe për terene sporti 1.5 m² / banor
- për lagje banimi sipërfaqe për terene sporti 1.5 m² / banor
- për grup banimi sipërfaqe për lojë fëmijësh 1.3 m² / banor
- për bllok banimi sipërfaqe për lojë fëmijësh 1.5 m² / banor
- për kompleks banimi sipërfaqe për lojë fëmijësh 1.5 m² / banor
- për lagje banimi sipërfaqe për lojë fëmijësh 1.5 m² / banor

E) Rrugët, vendqëndrimet dhe sheshet (sipërfaqet e lira) bëjnë pjesë :

- Sipërfaqet e rrugëve kryesore të qytetit së bashku me trotoaret
- Sipërfaqet e rrugëve brenda lagjeve dhe komplekseve të banimit
- Sipërfaqet e shesheve dhe hapësirave të lira
- Sipërfaqet e vendqëndrimeve të automjeteve (të hapura ose të mbyllura)

Sipërfaqet e rrugëve kryesore të qytetit së bashku me trotoaret

- **Rrugët e kategorisë së I – rë :** Rrugët me 4 - 6 korsi kalimi janë rrugët e kryesore të shërbimit urban dhe rrugët unazore të qytetit me trafik të rëndë .
- **Rrugët e kategorisë së II – të :** Rrugët me 3 - 4 korsi kalimi janë rrugët që ndajne lagjet banuese të qytetit nga njëra tjetra .
- **Rrugët e kategorisë së III – të :** Rrugët me 2 korsi kalimi janë rrugët e mbrendshme të lagjeve banuese.
- **Rrugët e kategorisë së IV – të :** Rrugët me 1 - 2 korsi kalimi janë rrugët e mbrendshme të blloqeve të banimit .



Sipërfaqet e rrugëve brenda lagjeve dhe komplekseve të banimit

- Rrugë me dy korsi kalimi + dy breza parkimi
- Rrugë me dy korsi kalimi + një brez parkimi
- Rrugë me një korsi kalimi + dy breza parkimi
- Rrugë me një korsi kalimi + një brez parkimi

Ndalesat e kyçjeve në rrugë dhe kyqjet në rrugë sipas kategorive të tyre

Ndalohet dalja në rrugët e kategorisë së parë nga rrugët e kategorisë së katërt .

Ndalohet dalja e çdo rruge më afër se 50 m nga kryqëzimi . Distanca minimale e daljeve në rrugët e kategorisë së I-rë e II-të duhet të jetë 100m. Distanca minimale e daljeve në rrugët e kategorisë së III-të e IV-të duhet të jetë 50m

Kryqezimet e rrugëve sipas kategorive bëhen :

- Me disnivel apo me rreth për dy rrugë të kategorisë së parë
- Me disnivel apo me rreth për rrugë të kategorisë së parë me rrugë të kategorisë së dytë
- Sipas kushteve në dispozicion për rrugët e kategorive tjera

Rrugët e kategorisë së parë dhe të dytë nuk duhet të përshkojnë : grupin e banimit , bllokun e banimit , kompleksin e banimit dhe lagjen e banimit.

Sipërfaqet e shesheve dhe hapësirave të lira

Sipërfaqet e shesheve dhe hapësirave të lira përbëjnë sipërfaqet e nevojshme për shtrirjen e infrastrukturës rrugore dhe sipërfaqen e hapësirave të lira :

Treguesit normativ janë :

- Për grup banimi sipërfaqe për rrugë dhe sheshe midis grupeve 1.5 m² / banor
- Për kompleks banimi sipërfaqe për rrugë dhe sheshe 3.0 m² / banor
- Për të gjitha kategoritë e tereneve të banimit nga grupi i banimit e deri te lagja e banimit nevojiten sipërfaqe për hapësira të lira 10,0 m² / banor



Sipërfaqet e vendqëndrimeve të automjeteve (të hapura ose të mbyllura)

Sipërfaqet e nevojshme për zhvillimin e parkimeve të hapura dhe të mbyllura janë 15 m² / 1 parkim :

- | | | |
|--------------------------|----------------------------------|--------|
| • per banesa kolektive | nje vendparkim per familje | 1 / 1 |
| • për biblioteka | një vendparkim / 25 veta | 1 / 25 |
| • për qendra tregtare | një vendparkim / 3 veta | 1 / 3 |
| • për qendra shëndetsore | një vendparkim / 25 veta | 1 / 25 |
| • për objekte shoqërore | 0.10 m ² / banor zone | |

Banor zone është numri i banorve të një zone që i shërben objekti i mësipërm

23. KUSHTET DHE KRITERET PËR MBROJTJE MJEDISORE

Kushtet dhe kriteret për mbrojtje mjedisore janë kushtet esenciale për lejimin e zhvillimit të përmbajtjeve komerciale, përpunuese, deponuese apo tregtare në hapësirat ekzistuese afariste dhe hapësirat e reja me destinim afarist apo në zonat e përcaktuara për zhvillimin e bizneseve.

Ndikimet në mjedis si zhurma dhe emitimi i gazrave nga trafiku janë kushte të cilat do të diktojnë zhvillimin e përmbajtjeve komerciale brenda zonave të banimit prandaj kordinimi dhe kooperimi më i madh ndërmjet sektorit privat dhe administra tës komunale i kontribuon zhvillimit të çështjeve biznesore .

24. KUSHTET DHE KRITERET PËR SHFRYTËZIM RACIONAL TË ENERGJISË

Shfrytëzimi racional i energjisë kushtëzohet edhe në vendet me zhvillim të lartë, prandaj as ne pamvarësisht gjendjes momentale apo përmirësimeve në të ardhmen nuk duhet të bëjmë përjashtim. Në këtë kontekst duhet ndërmarrë hapa emergjent rreth përmirësimit të situates dhe ngritjes së racionalitetit të shfrytëzimit të energjisë.

Kushtet dhe kriteret për shfrytëzim racional të energjisë janë :

- Sanimi i erëmbrojtësve të të gjitha hyrjeve të ndërtesave banesore dhe realizimi i tyre në ndërtesat në të cilat nuk ekzistojnë.
- Realizimi i erëmbrojtësve për të gjitha hapësirat komerciale, përpunuese apo tregtare me sipërfaqe mbi 12 m²



- Kyqja në sistemin e ngrohjes qendrore të bërthamave të shkallëve dhe koridoreve komunikuese të të gjitha ndërtesave banesore pasi të gjitha banesat kanë humbje të energjisë nga ana e tyre.
- Imponimi dhe kushtëzimi i finalizimit të objekteve të pafinalizuara me fasadë dhe trajtim termik të tyre.
- Përmirësimi i fasadës me trajtim termik i të gjitha objekteve të përfunduara e të cilat kanë pësuar dëmtime apo nuk kanë pasur trajtim adekuat termik.

25. KUSHTET URBANE PËR SIPËRFAQET PUBLIKE , PRIVATE SI DHE ELEMENTET PËRCJELLËSE

Dukuritë më të shëmtuara në mjediset tona urbane shfaqen si rezultat i mirë mbajtjes së dobët dhe kujdesit minimal të qytetarve ndaj hapësirave publike ekzistuese, prandaj duhet që komuna ti kushtoi rëndësi ngritjes së nivelit të mirë mbajtjes kurse qytetarët kujdes më të madh.

Kushtet optimale urbane për sipërfaqet publike aplikohen në raportet e teritorit dhe numrit të banorve . Në këtë aspekt rekomandohen të dhënat tabelare:

Hapësira publike	1.5 – 2.0 Ha	6.0 – 8.0 Ha	16 – 20 Ha
	750 – 1.000 banorë	3.000 – 4.000 banorë	6.000– 8.000 banorë
Sipërfaqe e lirë	6.0 m ² / banor	10.0 m ² / banor	10.0 m ² / banor
Sipërfaqe gjelbëruese	4.0 m ² / banor	2.5 m ² / banor	1.5 m ² / banor
Sip. për lojë fëmijësh	1.3 m ² / banor	1.5 m ² / banor	1.5 m ² / banor
Sip. për terene sporti		0.5 m ² / banor	1.5 m ² / banor
Rrugë dhe sheshe		1.5 m ² / banor	3.0 m ² / banor
Gjithësejt	11.3 m ² / banor	16.0 m ² / banor	17.5 m ² / banor

26. KUSHTET E DHE RREGULLORET E DOMOSDOSHME PËR LËSHIMIN E LEJES NDËRTIMORE , SIPAS VENDIT DHE LLOJIT TË OBJEKTIT QË ËSHTË DUKE U NDËRTUAR

Kushtet për lëshimin e lejes ndërtimore , sipas vendit dhe llojit të objektit që është duke u ndërtuar duhet të trajtohen në mbështetje të ligjeve të aplikueshme dhe rregulloreve komunale të cilat duhet hartuar.



27. VLERAT ME RËNDËSI NATYRORE, KULTURORE DHE HISTORIKE

Lagja e Dardanisë është lagje relativisht e re dhe si e tillë ka filluar së zhvilluari në hapësirë territoriale të lire apo mbi koncepte urbanistike pa përfillur vlera natyrore e ndoshta edhe kulturore dhe historike. Në këtë kontekst si vlerë natyrore do të kualifikohej vetëm rihapja e lumit Prishtina.

28. KUSHTET PËR MBROJTJE NGA ZJARRI DHE FATKEQËSITË TJERA SI DHE SHKATËRRIMET

Kushtet për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera janë çështje të rëndësishme të cilat duhet trajtuar në suazat e ligjeve përkatëse të aplikueshme.

Elemente esenciale Kur ndërtesat vendosen përbri njëra – tjetrës dhe faqet në brinjë nuk kanë dritare mund të largohen deri në 1 m apo në bashkim të plotë duke respektuar diletimin me kusht që të merren masa të caktuara për mbrojtje nga zjarri duke lënë nënkalime me gjerësi 4m dhe lartësi 5m .

29. REZYME E REKOMANDIMEVE TË PËRGJITHSHME

- Për Zonën 8 si tërësi të hartohet projekt i veçantë i zgjidhjes urb-arkitektonike, pa zgjidhje parciale, implementimi i të cilit sipas dispozitave të këtij plani do të bëhet nëpër blloqe
- Për mbindërtimet dhe shndërrimet duhet të hartohet një Studim dhe Hulumtim i veçantë i tyre, në bazë të të cilit Komuna nxjerr vendimet lidhur me kushtet, mënyra dhe procedura për trajtimin.
- Të pastrohen pusetat – të vendosen kapakët e tyre me shenjzëzim
- Të riaktivizohet dhe të rivendoset ndriçimi adekuat në hapësirat dhe sipërfaqet publike
- Të largohen të gjitha llojet e përçuesve dhe kablllove ajrorë
- Të sigurohen kutitë e instalimeve elektrike
- Të izoloohen dhe të mbrohen instalimet e ngrohjes dhe instalimet tjera
- Parkingjet e hapura - të jepen në konçesion si formë e menaxhimit
- Parkingjet e hapura të riasfaltohen në të njëjtën kohë si edhe rrugët automobilistike dhe trotualet



- Shtigjet e këmbësorëve të pllakëzohen
- Rrugët banimore të ripllakëzohen
- Të vendoset shenjëzimi horizontal dhe vertikal si dhe të sinjalizohet komunikacioni
- Të pastrohen dhe të sigurohen vend-kalimet e mbuluar me prizma të qelqit të armuar
- Të montohet dhe të ngjyroset gardhi nëpër shkallë dhe rampa publike
- Të pastrohen apo montohen ulluqet horizontale dhe vertikale në ndërtesa
- Të pastrohen sipërfaqet e objekteve të shkruara me grafit
- Të largohen panotë dhe reklamat pa leje që paraqesin pengesë për banorët dhe konsumatorët
- Të vendosen interfonat, pllakat me emërtimet e hyrjeve në ndërtesa dhe emërtimet e rrugëve
- Të vendosen pllakat me emërtimet e rrugëve
- Të vendosen në korridor të banesave tabela dhe sirtarët e banorëve
- Të riparohen dhe të riaktivizohen ashensorët
- Të rrënohen zgjerimet dhe uzurpimet e ballkoneve, lozhave dhe terrasave – parapetet e tyre dhe rrethojat të kthehen në gjendjen e projektuar – Të insistohet në garat për kultivim të luleve dhe ballkon më të bukur.
- Të largohen antenat satelitore dhe elementet e tjera që prishin dukjet e ndërtesave.
- Të vendosen pajisjet e lojërave dhe rërës për fëmijë në kuadër të sipërfaqeve gjelbëruese
- Të montohen rekuizitat për sportet e vogla
- Të pastrohen, të ripërtërihen dhe të kultivohen sipërfaqet gjelbëruese para objekteve
- Të mirëmbahet gjelbërimi ekzistues dhe të krijohet tamponi gjelbërues



- Të vendosen bankat për ulje dhe pushim pranë shtigjeve të këmbësorëve në kuadër të sipërfaqeve gjelbëruese
- Të pastrohen mbeturinat – të vendosen kontejnerët e mbeturinave
- Zgjerimet e lokaleve afariste dhe hapësirave publike të rrënohen – të kthehen në gjendjen e projektuar.
- Disa lokaleve - të iu kthehet destinimi sipas gjendjes së projektuar
- Hapësirat e përmbajtjeve publike – të lirohen dhe të vendosen në funksionin e projektuar



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PRISHTINËS

Drejtoria i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



Pjesa grafike



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PRISHTINËS

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

